



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

R A P O R T I
I PUNËS SË GJYKATËS SUPREME TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË
VERIUT
PËR VITIN 2020

Shkup, viti 2021

HYRJE

Gjykata supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, paraqet kategorinë kushtetuese pozita e të cilës krahas gjykatave tjera në pushtetin gjyqësor është e shënuar në nenin 101 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, si gjykatë më e lartë në Republikë dhe siguron unitetin në zbatimin e ligjeve nga ana e gjykatave.

Në vitin raportues 2020, Gjykata supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut kompetencat e saj kushtetuese dhe ligjore i realizoi në kushte të jashtëzakonshme si rezultat i pandemisë së shkaktuar nga Covid-19.

Edhe krahas kushteve të këtilla rënduese, sipas Ligjit të gjykatave, në suaza të kompetencës reale të saj, Gjykata supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut si gjykatë më e lartë vendos në shkallën e tretë dhe të fundit për ankesat kundër vendimeve të gjykatave të apelit, për mjete të jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve të plotfuqishme të gjykatave dhe vendimeve të këshillave të tyre, kur ajo është e paraparë me ligj, për ndeshje të kompetencave dhe për përcaktimin e kompetencës vendore, vendos për kërkesa për cenimin e të drejtës së gjykimit në afatin e arsyeshëm, në shkallën e parë dhe të dytë, në procedurë të shënuar me ligj në gjykatat e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në pajtim me rregullat dhe principet e shënuara me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njerëzve dhe Lirive Themelore dhe duke u nisur nga praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njerëzve dhe çështje tjera të shënuara me ligj.

Kompetencën e saj, Gjykata e realizon përmes **Sektorit të veprave penale, Sektorit të veprave civile, Sektorit për gjykim në afat të arsyeshëm, këshillave të specializuara për procedimin** e kërkesave për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutën, për ankesat e kandidatëve të cilët nuk janë zgjedhur për gjyqtarë respektivisht për Kryetarë gjykatë dhe për ankesa kundër vendimeve të Këshillit gjyqësor të RMV për shkarkimin e gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave në këshillat ankimore të formuara përmes shortit.

Kompetencën e saj për unifikimin e praktikës gjyqësore, Gjykata e realizon në **Seancën e përgjithshme** përmes konstatimit të qëndrimeve juridike dhe mendimeve juridike parimore, përmes mendimeve juridike dhe konkluzioneve për çështje juridike të miratuara në Seancën e sektorëve gjyqësor, përgatitjen e sentencave të miratuara në seancat e sektorëve gjyqësor, të cilat publikohen në faqen zyrtare të Gjykatës. Po ashtu, unifikimi i praktikës gjyqësore realizohet dhe ndiqet edhe përmes **Sektorit të praktikës gjyqësore**.

Në Gjykatën supreme, për përdorimin dhe avancimin e sistemit të automatizuar kompjuterik për administrimin e lëndëve në gjykatat, me Vendim të Kryetarit të Gjykatës formohet dhe funksionon Trupi punues për standardizimin e procedurave në gjykata që është i karakterit të përhershëm dhe të sesioneve të përhershme, të cilin e udhëheq gjyqtar i Gjykatës supreme.

Sipas Ligjit të gjykatave, në Gjykatën supreme është e formuar dhe funksionon qendra e informatikës me bazën e të dhënave për teknologjinë informatike kompetente për administrimin teknik me sistemin e automatizuar kompjuterik për administrimin me lëndët gjyqësore dhe me bazat e të dhënave që burojnë nga puna e gjykatave.

Vëllimi dhe intensiteti i punës është shprehur përmes të dhënave për veprimin me lëndë të llojeve konkrete gjatë tërë vitit në sektorët dhe këshillat e specializuara dhe masa e aktivitete tjera, që janë ndërmarrë në këtë Gjykatë, si gjykatë më e lartë në Republikën.

VENDIMMARJA E LËNDËVE NË NIVEL TË GJYKATËS

Gjykata supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, kompetencat e saj kushtetuese dhe ligjore në vitin raportues 2020, i realizoi në rrethana të jashtëzakonshme si rezultat i pandemisë së shkaktuar nga KOVID-19.

Edhe krahas rrethanave të këtylla, Gjykata supreme e tejkaloi grumbullimin e lëndëve dhe e zvogëloi numrin e lëndëve të pa kryera për 322 lëndë.

Në vitin 2020, Gjykata supreme ka pasur gjithsej 2.512 lëndë në punë nga të gjitha llojet.

Viti ka filluar me 1.255 lëndë të pakryera nga viti 2019, ndërsa gjatë vitit janë pranuar 2.247 lëndë të reja. Prej tyre janë kryer 2.569 lëndë, 943 lëndë kanë mbetur të pa kryera, 15 lëndë janë evidentuar përsëri në punë, 5 lëndë udhëhiqen si lëndë të evidentuara gabimisht.

Raport sipas sektorëve për periudhën prej datës 01.01.2020 deri më 31.12.2020

Tabela 1

| Sfera | Sfera civile | | | | | | |
|--|--|--------------------|-----------------|--------------------------|------------------|-------------|-------------|
| Lloji i lëndës | | | | | | | |
| Nënllloji i lëndës | Të pa kryera | Të reja të pranuar | Përsëri në punë | Të evidentuara gabimisht | Gjithsej në punë | Të kryera | Kanë mbetur |
| Lëndë të ndryshme civile dhe ndeshje të kompetencave të ndryshme | 15 | 134 | 0 | 2 | 147 | 134 | 13 |
| Gjithsej – lloji i lëndës | 15 | 134 | 0 | 2 | 147 | 134 | 13 |
| Lloji i lëndës | Lëndë civile sipas revizionit | | | | | | |
| Nënllloji i lëndës | Të pa kryera | Të reja të pranuar | Përsëri në punë | Të evidentuara gabimisht | Gjithsej në punë | Të kryera | Kanë mbetur |
| Konteste ekonomike - revizion | 226 | 155 | 1 | 0 | 382 | 245 | 137 |
| Konteste pune - revizion | 194 | 189 | 0 | 0 | 383 | 277 | 106 |
| Konteste civile - revizion | 483 | 477 | 2 | 1 | 961 | 577 | 384 |
| Gjithsej - lloji i lëndës | 903 | 821 | 3 | 1 | 1726 | 1099 | 627 |
| Gjithsej - sfera | 918 | 955 | 3 | 3 | 1873 | 1233 | 640 |
| Sfera | Sfera penale | | | | | | |
| Lloji i lëndës | | | | | | | |
| Nënllloji i lëndës | Të pa kryera | Të reja të pranuar | Përsëri në punë | Të evidentuara gabimisht | Gjithsej në punë | Të kryera | Kanë mbetur |
| Lëndë të ndryshme penale | 6 | 620 | 0 | 0 | 626 | 573 | 53 |
| Mbrojtje e ligjshmërisë sipas lëndëve penale | 10 | 15 | 0 | 0 | 25 | 20 | 5 |
| Zbutje e jashtëzakonshme e dënimit | 8 | 21 | 0 | 0 | 29 | 27 | 2 |
| Gjithsej – lloji i lëndës | 24 | 656 | 0 | 0 | 680 | 600 | 60 |
| Lloji i lëndës | Shqyrtimi i jashtëzakonshëm i vendimit të plotfuqishëm | | | | | | |
| Nënllloji i lëndës | Të pa kryera | Të reja të pranuar | Përsëri në punë | Të evidentuara gabimisht | Gjithsej në punë | Të kryera | Kanë mbetur |

| | | | | | | | |
|---|--|---------------------------|------------------------|---------------------------------|-------------------------|------------------|--------------------|
| Shqyrtim i jashtëzakonshëm i vendimit të plotfuqishëm krimi organizuar-këshill prej pesë gjyqtarëve | 11 | 11 | 0 | 0 | 22 | 17 | 5 |
| Shqyrtim i jashtëzakonshëm i vendimit të plotfuqishëm – këshill prej pesë gjyqtarëve | 96 | 142 | 0 | 1 | 237 | 180 | 57 |
| Shqyrtim i jashtëzakonshëm i vendimit të plotfuqishëm – këshill prej tre gjyqtarëve | | | | | | | |
| Gjithsej – lloji i lëndës | 107 | 153 | 0 | 1 | 259 | 197 | 62 |
| Lloji i lëndës | Lëndë penale të shkallës së tretë | | | | | | |
| Nënllloji i lëndës | Të pa kryera | Të reja të pranuar | Përsëri në punë | Të evidentuara gabimisht | Gjithsej në punë | Të kryera | Kanë mbetur |
| Ankesa të aktgjyqimeve në shkallën e tretë | 23 | 49 | 0 | 1 | 71 | 60 | 11 |
| Ankesa të aktvendimeve për parburgim | 0 | 56 | 0 | 0 | 56 | 52 | 4 |
| Gjithsej – lloji i lëndës | 23 | 105 | 0 | 1 | 127 | 112 | 15 |
| Gjithsej - sfera | 154 | 914 | 0 | 2 | 1066 | 929 | 137 |
| Sfera | Gjykim në afat të arsyeshëm | | | | | | |
| Lloji i lëndës | Gjykim në afat të arsyeshëm – të shkallës së dytë | | | | | | |
| Nënllloji i lëndës | Të pakryera | Të reja të pranuar | Përsëri në punë | Të evidentuara gabimisht | Gjithsej në punë | Të kryera | Kanë mbetur |
| Gjykim në afat të arsyeshëm - ankesa | 31 | 128 | 0 | 0 | 159 | 121 | 38 |
| Gjithsej – lloji i lëndës | 31 | 128 | 0 | 0 | 159 | 121 | 38 |
| Lloji i lëndës | Gjykim në afat të arsyeshëm - të shkallës së parë | | | | | | |
| Nënllloji i lëndës | Të pakryera | Të reja të pranuar | Përsëri në punë | Të evidentuara gabimisht | Gjithsej në punë | Të kryera | Kanë mbetur |
| Gjykim në afat të arsyeshëm - Administrative | 67 | 93 | 0 | 0 | 160 | 99 | 61 |
| Gjykim në afat të arsyeshëm - Penale | 45 | 49 | 0 | 0 | 94 | 64 | 30 |
| Gjykim në afat të arsyeshëm - Civile | 33 | 91 | 0 | 0 | 124 | 99 | 25 |
| Gjithsej – lloji i lëndës | 145 | 233 | 0 | 0 | 378 | 262 | 116 |
| Gjithsej – sfera | 176 | 361 | 0 | 0 | 537 | 383 | 154 |
| Sfera | Sfera administrative | | | | | | |
| Lloji i lëndës | | | | | | | |
| Nënllloji i lëndës | Të pakryera | Të reja të pranuar | Përsëri në punë | Të evidentuara gabimisht | Gjithsej në punë | Të kryera | Kanë mbetur |
| Mbrojtja e ligjshmërisë në kontest administrativ | 2 | 4 | 0 | 0 | 6 | 3 | 3 |
| Ankesa kundër vendimeve | 4 | 10 | 0 | 0 | 14 | 9 | 5 |

| | | | | | | | |
|--|--|---------------------------|------------------------|---------------------------------|-------------------------|------------------|--------------------|
| të Gjykatës administrative | | | | | | | |
| Gjithsej – lloji i lëndës | 6 | 14 | 0 | 0 | 20 | 12 | 8 |
| Gjithsej - sfera | 6 | 14 | 0 | 0 | 20 | 12 | 8 |
| Lloji i lëndës | Ankesa kundër vendimeve të KGJRMV | | | | | | |
| Nënloji i lëndës | Të pakryera | Të reja të pranuar | Përsëri në punë | Të evidentuara gabimisht | Gjithsej në punë | Të kryera | Kanë mbetur |
| Ankesa kundër vendimeve të KGJRMV – për zgjedhje | 0 | 3 | 0 | 0 | 3 | 3 | 0 |
| Gjithsej – lloji i lëndës | 0 | 3 | 0 | 0 | 3 | 3 | 0 |
| | | | | | | | |
| Gjithsej | 1254 | 2247 | 3 | 5 | 3499 | 2560 | 939 |

Të dhënat e Administratës gjyqësore nga fushëveprimi i punës së Kryetarit të gjykatës janë shfaqur në Tabelën 2

Tabela 2

| Sfera | Administrata gjyqësore | | | | | | |
|-------------------------------------|---|---------------------------|------------------------|---------------------------------|-------------------------|------------------|--------------------|
| Lloji i lëndës | Evidenca e administratës gjyqësore | | | | | | |
| Nënloji i lëndës | Të pa kryera | Të reja të pranuar | Përsëri në punë | Të evidentuara gabimisht | Gjithsej në punë | Të kryera | Kanë mbetur |
| Lëndë të administratës gjyqësore | 0 | 2057 | 0 | 0 | 2057 | 2057 | 0 |
| Gjithsej – lloji i lëndës | 0 | 2057 | 0 | 0 | 2057 | 2057 | 0 |
| Lloji i lëndës | Parashtrësia dhe ankesa | | | | | | |
| Nënloji i lëndës | Të pa kryera | Të reja të pranuar | Përsëri në punë | Të evidentuara gabimisht | Gjithsej në punë | Të kryera | Kanë mbetur |
| Qasje të lirë në informacione | 0 | 43 | 1 | 0 | 44 | 44 | 0 |
| Evidenca e parashtrësive dhe ankesa | 0 | 159 | 0 | 0 | 159 | 159 | 0 |
| Gjithsej – lloji i lëndës | 0 | 202 | 1 | 0 | 203 | 203 | 0 |
| Gjithsej - sfera | 0 | 2259 | 1 | 0 | 2260 | 2260 | 0 |

Parashtrësia, propozime dhe kërkesa tjera nga administrata gjyqësore

Gjatë vitit **2020**, në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, janë pranuar gjithsej **160** parashtrësia të evidentuara në Regjistrin UPP.

Prej gjithsej parashtrësive të parashtrëna, të evidentuara në Regjistrin UPP, **105** janë kërkesa për kryerjen më të shpejtë të lëndëve, ndërsa **55** janë parashtrësia nga qytetarë, institucione dhe organe tjera shtetërore.

Sipas Rregullores së punës së Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Kryetari prej gjithsej **105** kërkesave të reja të pranuar për kryerjen me prioritet të lëndëve, ka miratuar **45**, ka refuzuar **13**, ndërsa për lëndët tjera janë marrë informacione se lëndët janë marrë në punë, respektivisht se procedura e lëndës konkrete ka përfunduar, kurse lënda është ekspeduar në gjykatën më të ulët kompetente.

Prej gjithsej **160** parashtrësive të dorëzuara, të evidentuara në Regjistrin UPP, janë evidentuar **12** parashtrësia të Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe **5**

parashtresa të Avokatit të Popullit me kërkesë për informacion lidhur me revizion të parashtuar, kohëzgjatja e procedurës dhe të tjera.

Për kërkesat e parashtuara sipas bazave të ndryshme të evidentuara në Regjistrin UPP, Gjykata supreme ka vepruar sipas Ligjit për gjykatat, Ligjit për veprim ndaj parashtresave dhe propozimeve, sipas Rregullores së punës së Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Rregullores gjyqësore dhe sipas Ligjit për udhëheqje me qarkullimin e lëndëve në gjykata.

Kërkesa për përjashtim – SU – IZZ / 2020

Numri total i kërkesave të parashtuara për përjashtim: 110

- numri i kërkesave të parashtuara nga palët për përjashtimin e gjyqtarit; 4
- numri i kërkesave të parashtuara nga palët për përjashtimin e kryetarit të gjykatës më të ulët; 7
- numri i kërkesave të parashtuara nga gjyqtar i GJSRMV për përjashtimin e gjyqtarit; 96
- numri i kërkesave për përjashtim të parashtuara nga kryetar i gjykatës drejtuar kryetarit të gjykatës më të lartë; 3

Vendime të publikuara, të anonimizuara

Publikimi i vendimeve, në faqen zyrtare të gjykatës zhvillohet në vazhdimësi siç është paraparë në Ligjin për udhëheqje me qarkullimin e lëndëve, të shfaqur në tabelën sipas sferave.

Tabela 1

| | |
|---|--------------|
| Penale | 302 |
| Civile | 1098 |
| Në afat të arsyeshëm PSRRG – PSRRK - PSRRU | 253 |
| Ankesa në afat të arsyeshëm PSRRZH | 122 |
| USPIZH | 9 |
| UZZ | 3 |
| GJITHSEJ: | 1.787 |

Informacione për punën e Zyrës për marrëdhënie me publikun

Zyra për marrëdhënie me publikun pranë Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, vazhdimisht publikon njoftime në Portalin gjyqësor me qëllim për informim të opinionit për punën e Gjykatës, njoftime për aktivitetet e kryetarit dhe të gjyqtarëve, pjesëmarrjen e tyre në konferencat ndërkombëtare, seminare, punëtori, trajnime dhe mbledhje, si dhe informimin e publikut për mbledhje dhe vizita nga delegacione, përfaqësues të institucioneve, projekte ku përfshihet edhe Gjykata supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Publikohen njoftime edhe për informimin e lëndëve, për të cilat shfaqet interes i madh në opinion.

Kërkesa sipas Ligjit për qasje të lirë në informacione me karakter publik

Në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, gjatë vitit 2020 janë pranuar gjithsej dyzet e një (41) kërkesa për qasje në informacione me karakter publik.

Për të gjitha kërkesat për qasje në informacione me karakter publik, të pranuar në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, gjatë periudhës raportuese është vepruar dhe përgjigjur. Kërkesa pa përgjigje nuk ka.

Numri i kërkesave me përgjigje pozitive numëron tridhjetë e katër (34)

Dy (2) kërkesa janë dërguar në gjykata tjera sipas nenit 18 paragrafi 1 të Ligjit për qasje të lirë në informacione me karakter publik;

Për pesë (5) kërkesa për qasje në informacione me karakter publik, të parashtruara nga organizatat të sektorit joqeveritar është vepruar në mënyrë që kërkuarit i është dorëzuar njoftim me shkrim.

Kërkesa të refuzuara dhe të hedhura poshtë nuk ka.

Gjatë vitit 2020 janë parashtruar dy (2) ankesa kundër aktvendimeve të GJSRMV, të cilave pozitivisht u është përgjigjur kërkesave për qasje në informacione me karakter publik:

-Në rastin e parë, Agjencia për mbrojtjen e të drejtës së qasjes së lirë në informacionet me karakter publik, me aktvendim 08-70 të datës 10.03.2020 e refuzoi ankesën si të pabazë dhe e konfirmoi aktvendimin e GJSRMV.

-Në rastin e dytë, me aktvendim të Agjencisë nr. 08- 712 të datës 09.12.2020, procedura e ankesës është ndërprerë.

Gjatë vitit 2020, dy (2) ankesa të parashtruara në vitin 2019 janë aprovuar nga ana e Agjencisë. Bëhet fjalë për kërkesa për qasje në informacione me karakter publik nga viti 2019, të cilave u janë dhënë përgjigje pozitive, por megjithatë kërkuarit nuk kanë qenë të kënaqur nga përgjigja e marrë andaj kanë parashtruar ankesa.

Të dy aktvendimet e Agjencisë, me të cilat janë aprovuar ankesat në fjalë janë zbatuar në atë mënyrë që parashtruesve u janë dorëzuar aktvendime të GJSRMV, me të cilat u është dhënë përgjigje pozitive për kërkesat dhe janë dhënë informacionet e kërkuara.

VËLLIMI DHE VENDIMARRJA SIPAS SEKTORËVE

SEKTORI I VEPRAVE PENALE

Në Sektorin e veprave penale, gjatë vitit 2020 sipas Vendimit për Orarin vjetor të punës së gjyqtarëve dhe të administratës gjyqësore të datës 16.01.2020 janë sistemuar 5 (pesë) gjyqtarë, ashtu që njëri nga anëtarët e këshillit nuk angazhohet me lëndë, si dhe dy gjyqtarë si zëvendës anëtarë po ashtu nuk angazhohen me lëndë.

Pas zgjedhjes së realizuar të gjyqtarëve më datë 16.03.2020 në Gjykatën supreme, dy gjyqtarë janë caktuar me orar në Sektorin e veprave penale, në atë mënyrë që është arritur pajisja me kuadro, dhe me atë është rritur efikasiteti në procedimin sipas lëndëve që i nënshtrohet edhe numrit total të lëndëve të kryera deri në fund të vitit.

Me orarin e punës në Sektorin e veprave penale janë sistemuar sekretar dhe zëvendës sekretar i Sektorit, nga radha e bashkëpunëtorëve profesional gjyqësor, bashkëpunëtorë profesional gjyqësor që vepruan me të gjitha llojet e lëndëve dhe udhëheqës i sportelit të Sektorit për realizimin e punëve administrative.

Pasqyra totale e punës sipas lëndëve

Gjatë vitit raportues **2020** janë pranuar **912** lëndë të reja, **154** lëndë kanë mbetur nga muaji nëntor i vitit **2019**, ose gjithsej në punë kanë qenë **1.066** lëndë sipas të gjitha bazave. Gjatë vitit raportues gjyqtarët kanë kryer **929** lëndë, ndërsa në fund të vitit kanë mbetur të pakryera **137** lëndë nga të gjitha bazat. Sipas kësaj, rritja e numrit është tejkualuar për **87,14%**.

Pasqyra e gjithsej lëndëve të kryera dhe të pa kryera sipas bazave të ndryshme, në vitin 2020 është dhënë në **tabelën 1**.

Tabela 1

| Lloji i lëndëve | Kanë mbetur nga muaji XII 2019 | Të pranuar në vitin 2020 | Gjithsej në punë | Të kryera | Të pa kryera |
|-----------------|--------------------------------|--------------------------|------------------|------------|--------------|
| VKZH1 | - | 56 | 56 | 52 | 4 |
| VKZH2 | 23 | 48 | 71 | 60 | 11 |
| KVP1 | - | - | - | - | - |
| KVP2 | 96 | 141 | 237 | 180 | 57 |
| Kvp-KOK1-Kvp | - | - | - | - | - |
| Kvp-KOK2-Kvp | 11 | 11 | 22 | 17 | 5 |
| VUK | 8 | 21 | 29 | 27 | 2 |
| KZZ | 10 | 15 | 25 | 20 | 5 |
| KR | 6 | 620 | 626 | 573 | 53 |
| GJITHSEJ | 154 | 912 | 1066 | 929 | 137 |

Lëndët që kanë mbetur të pakryera në fund të vitit 2020 i nënshtrohen asaj që një pjesë e lëndëve nuk janë kryer nga gjyqtari i sistemuar sipas orarit në Sektorin e veprave penale, i cili më datë 28.01.2020 u shkarkua me Vendim të Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Një pjesë e madhe e lëndëve në Gjykatë janë pranuar në muajin e fundit të vitit raportues, me ç' rast ka qenë e pamundshme të merren në punë, për shkak se janë dhënë për mendim në Prokurorinë publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, e cila i mban edhe pas skadimit të afatit ligjor për dorëzim të përgjigjes dhe mendimit në këtë gjykatë. Po ashtu, kah fundi i vitit raportues janë pranuar **928** lëndë nga të cilat **396** lëndë, respektivisht **42,67%** ishin sipas Ligjit për shoqëritë tregtare.

Gjyqtarët e Sektorit të veprave penale, të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në vitin 2020 kanë kryer gjithsej **KVP2 – 180** lëndë, **Kvp.KOK2 – 17** lëndë, ashtu që gjithsej **KVP2** dhe **Kvp.KOK2** janë **197** lëndë, **VKZH1 – 52** lëndë, **VKZH2 – 60** lëndë, **VUK – 27** lëndë, **KZZ – 20** lëndë dhe **KR – 573** lëndë.

Struktura e lëndëve të kryera sipas llojit të veprave penale

Struktura e lëndëve të kryera, sipas llojit të veprave penale për kërkesat për shqyrtimin e jashtëzakonshëm të vendimit të plotfuqishëm – **KVP1, KVP2, Kvp.KOK1 dhe Kvp.KOK2**, e gjithsej 197 lëndëve, është si vijon:

Kreu XIV nga Kodi penal

Vepra penale kundër jetës dhe trupit

35 lëndë për vepër penale – Vrasje – **neni 123**;

20 lëndë për vepër penale – Lëndim trupor – **neni 130**;

9 lëndë për vepër penale – Lëndim i rëndë trupor – **neni 131**;

1 lëndë për vepër penale – Pjesëmarrje në rrahje – **neni 132**;

Kreu XV nga Kodi penal

Vepra penale kundër lirisë dhe të drejtave të njeriut dhe qytetarit

- 3 lëndë për vepër penale – Rrëmbimi – **neni 141**;
- 5 lëndë për vepër penale – Keqtrajtimi gjatë kryerjes së detyrës - **neni 143**;
- 5 lëndë për vepër penale – Rrezikimi i sigurisë – **neni 144**.

Kreu i XVII nga Kodi penal

Vepra penale kundër marrëdhënieve të punës

- 2 lëndë për vepër penale – Cenimi i të drejtave nga marrëdhënia e punës – **neni 166**

Kreu XIX nga Kodi penal

Vepra penale kundër lirisë dhe moralit gjinor

- 4 lëndë për vepër penale – Dhunimi – **neni 186**;
- 4 lëndë për vepër penale – Kryerja e aktit seksual me person të paaftë – **neni 187**;
- 23 lëndë për vepër penale – Sulmi seksual ndaj të miturit që nuk ka mbushur 14 vjet – **neni 188**;
- 1 lëndë për vepër penale – Prodhimi dhe ekspozimi i pornografisë fëmijërore – **neni 193-a**;
- 2 lëndë për vepër penale – Incesti – **neni 194**.

Kreu XX nga Kodi penal

Vepra penale kundër martesës, familjes dhe rinisë

- 1 lëndë për vepër penale – Marrja e të miturit – **neni 198**;
- 2 lëndë për vepër penale – Lënia pas dore dhe keqtrajtimi i personit të mitur – **neni 201**.

Kreu XXI nga Kodi penal

Vepra penale kundër shëndetit të njerëzve

- 1 lëndë për vepër penale – Kuazimjekësia (Pseudo mjekësia) – **neni 209**;
- 1 lëndë për vepër penale – Prodhimi dhe lëshimi në qarkullim i produkteve të dëmshme ushqimore dhe produkteve tjera – **neni 213**;
- 60 lëndë për vepër penale – Prodhimi i paautorizuar dhe lëshimi në qarkullim i drogave narkotike, substancave psikotrope dhe pre kursorëve – **neni 215**.

Kreu XXII nga Kodi penal

Vepra penale kundër mjedisit ajror dhe natyrës

- 2 lëndë për vepër penale – Uzurpimi i paluhajtshmërive – **neni 225**;
- 1 lëndë për vepër penale – Eksploatimi jologjor i lëndëve të para minerale – **neni 225-a**;
- 1 lëndë për vepër penale – Gjuetia e paligjshme – **neni 228**.

Kreu XXIII nga Kodi penal

Vepra penale kundër pronës

- 7 lëndë për vepër penale – Vjedhja – **neni 235**;
- 16 lëndë për vepër penale – Vjedhja e rëndë – **neni 236**;
- 33 lëndë për vepër penale – Grabitja – **neni 237**;
- 2 lëndë për vepër penale – Fshehja – **neni 239**;
- 1 lëndë për vepër penale – Dëmtimi i sendeve të huaja – **neni 243**;
- 2 lëndë për vepër penale – Dëmtimi i të drejtave të huaja – **neni 244**;
- 2 lëndë për vepër penale – Ndërtimi i paligjshëm – **neni 244-a**;
- 11 lëndë për vepër penale – Mashtrimi – **neni 247**;
- 5 lëndë për vepër penale – Shtrëngimi (detyrimi, shantazhi) – **neni 258**;
- 2 lëndë për vepër penale – Shantazhi (kërcënimi) – **neni 259**.

Kreu XXV nga Kodi penal

Vepra penale kundër financave publike, qarkullimit të pagesave dhe ekonomisë

- 1 lëndë për vepër penale – Larja e parave dhe dobia tjetër e kundërligjshme e pasurisë – **neni 273**;
- 1 lëndë për vepër penale – Keqpërdorimi i procedurës për thirrje publike, dhënia e kontratës për furnizim publik apo partneritet publik – privat – **neni 275-c**;
- 1 lëndë për vepër penale – Mashtrimi doganor – **neni 278-a**;
- 5 lëndë për vepër penale – Fshehja e tatimit – **neni 279**;
- 1 lëndë për vepër penale – Përdorimi i paautorizuar i firmës së huaj – **neni 285**;
- 1 lëndë për vepër penale – Keqpërdorimi i autorizimit në ekonomi – **neni 287**.

Kreu XXVI nga Kodi penal

Vepra penale kundër sigurisë së përgjithshme të njerëzve dhe pronës

- 1 lëndë për vepër penale – Shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm – **neni 288**;
- 4 lëndë për vepër penale – Vepra të rënda kundër sigurisë së përgjithshme – **neni 292**.

Kreu XXVII nga Kodi penal

Vepra penale kundër sigurisë në komunikacionin publik

- 1 lëndë për vepër penale – Rrezikimi i sigurisë në trafik – **neni 297**;
- 1 lëndë për vepër penale – Të ushtruarit e pandërgjegjshëm të mbikëqyrjes së trafikut – **neni 299**;
- 12 lëndë për vepër penale – Vepra të rënda kundër sigurisë së njerëzve dhe pasurisë në trafik – **neni 300**;
- 1 lëndë për vepër penale – Mosdhënia e ndihmës personit të lënduar në fatkeqësi trafiku – **neni 301**.

Kreu XXX nga Kodi penal

Vepra penale kundër detyrës zyrtare

- 17 lëndë për vepër penale – Keqpërdorimi i pozitës dhe autorizimit zyrtar – **neni 353**;
- 4 lëndë për vepër penale – Të punuarit e pandërgjegjshëm gjatë detyrës – **neni 353-c**;
- 1 lëndë për vepër penale – Shpërdorimi i shërbimit – **neni 354**;
- 4 lëndë për vepër penale – Marrja e ryshfetit – **neni 357**;
- 1 lëndë për vepër penale - Ndërmjetësimi i kundërligjshëm – **neni 359**.

Kreu XXXI nga Kodi penal

Vepra penale kundër drejtësisë

- 1 lëndë për vepër penale – Parashtrimi i provave të rrejshme – **neni 366-a**;
- 1 lëndë për vepër penale – Të ndikuarit e paligjshëm ndaj dëshmitarëve – **neni 368-a**.

Kreu XXXII nga Kodi penal

Vepra penale kundër qarkullimit juridik

- 4 lëndë për vepër penale - Falsifikimi i dokumenteve – **neni 378**

Kreu XXXIII nga Kodi penal

Vepra penale kundër rendit publik

- 1 lëndë për vepër penale – Pengimi i personit në kryerjen e veprimit zyrtar – **neni 382**;
- 7 lëndë për vepër penale – Sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së punëve të sigurimit – **neni 383**;
- 16 lëndë për vepër penale – Dhuna – **neni 386**;
- 2 lëndë për vepër penale – Vetëgjyqësia (arbitrarizmi) – **neni 392**;
- 2 lëndë për vepër penale - Bashkimi kriminel – **neni 394**;
- 11 lëndë për vepër penale – Përpunimi, mbajtja dhe tregtia e palejuar e armës apo materieve shpërthyesë – **neni 396**.

Kreu XXXIV nga Kodi penal

Vepra penale kundër njerëzimit dhe të drejtës kombëtare

4 lëndë për vepër penale – Kontrabandë me emigrantë – **neni 418-b**;

6 lëndë për vepër penale – Organizimi i grupit dhe nxitje për kryerje të veprave tregti me njerëz, tregti me person të mitur dhe kontrabandë me emigrantë – **neni 418-c**;

2 lëndë për vepër penale – Tregtia me person të mitur – **neni 418-ç**;

1 lëndë për vepër penale – Marrja e pengjeve – **neni 427**.

Struktura e lëndëve të kryera sipas llojit për kundërvajtje, të evidentuara në Regjistrin -**KR** është si vijon:

- 10 lëndë – kundërvajtje nga LSKR;
- 6 lëndë – kundërvajtje nga Ligji për rendin dhe qetësinë publike;
- 3 lëndë – kundërvajtje nga Ligji për pyjet;
- 126 lëndë – kundërvajtje nga Ligji për automjetet;
- 396 lëndë – kundërvajtje nga Ligji për shoqëritë tregtare;
- 1 lëndë – kundërvajtje nga Ligji për pagesa me para në dorë;
- 1 lëndë – kundërvajtje nga Ligji për prodhimet për mbrojtjen e bimëve;
- 1 lëndë – kundërvajtje nga Ligji për orarin e punës të punëtorëve mobilë në komunikacionin rrugor dhe pajisjet për regjistrim në komunikacionin rrugor;
- 1 lëndë – kundërvajtje nga Ligji për peshkatari dhe akuakulturë;
- 1 lëndë – kundërvajtje nga Ligji për kontribute të sigurimit të obligueshëm;
- 2 lëndë – kundërvajtje nga Ligji për gjueti;
- 1 lëndë – kundërvajtje nga sfera e Regjistrimit qendror.

Nga gjithsej numri i **197** lëndëve për shqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit të plotfuqishëm sipas numrit të lëndëve dhe personave të dënuar, shfaqet në **tabelën 2**:

Tabela 2

| | Me 1 person | Me 2 persona | Me 3 persona | Me 4 persona | Me 5 persona | Me 7 persona | GJITHSEJ |
|-----------------|-------------|--------------|--------------|--------------|--------------|--------------|------------|
| KVP1 | - | - | - | - | - | - | - |
| KVP2 | 152 | 23 | 3 | 1 | 1 | - | 180 |
| KVP-KOK1 | - | - | - | - | - | - | - |
| KVP-KOK2 | 11 | 5 | - | - | - | 1 | 17 |
| Gjithsej | 163 | 28 | 3 | 1 | 1 | 1 | 197 |

Nga gjithsej numri i **197** lëndëve për shqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit të plotfuqishëm – **KVP1, KVP2, Kvp.KOK1 dhe Kvp.KOK2** sipas gjykatave të apelit dhe sipas vendimit të këshillit, gjendja është shfaqur në **tabelën 3**.

Tabela 3

| Gjykata | KVP1, KVP2 | | KVP-KOK1 | | KVP-KOK2 | |
|---------------------------|------------|--------------|-----------|--------------|-----------|--------------|
| | Të kryera | Të pa kryera | Të kryera | Të pa kryera | Të kryera | Të pa kryera |
| Gjykata e apelit Shkup | 102 | 27 | - | - | 17 | 5 |
| Gjykata e apelit Manastir | 27 | 9 | - | - | - | - |
| Gjykata e apelit Shtip | 35 | 11 | - | - | - | - |
| Gjykata e apelit Gostivar | 33 | 15 | - | - | - | - |
| GJITHSEJ | 197 | 62 | - | - | 17 | 5 |
| | | | | | 22 | |

Tregues për kërkesa të refuzuara, të aprovuara, të ndryshuara dhe të hedhura poshtë sipas të gjitha bazave

Gjendja e lëndëve sipas të gjitha bazave, për të cilat kanë vepruar gjyqtarët në Sektorin e veprave penale, është shfaqur në tabelën nr.4.

Tabela 4

| Lloji i lëndëve | Të refuzuara | Të aprovuar a | Në tjetër mënyrë | Të hedhura poshtë | Të kryera | Të pa kryera |
|-----------------|--------------|---------------|------------------|-------------------|-----------|--------------|
| VKZH1 | 46 | 3 | - | 3 | 52 | 4 |
| VKZH2 | 30 | 15 | 1 | 14 | 60 | 11 |
| KVP1 | - | - | - | - | - | - |
| KVP2 | 119 | 14 | - | 47 | 180 | 57 |
| VUK | 23 | 1 | 1 | 2 | 27 | 2 |
| KZZ | 5 | 12 | - | 3 | 20 | 5 |
| KR | 10 | 552 | 6 | 5 | 573 | 53 |
| Kvp.KOK1 | - | - | - | - | - | - |
| Kvp.KOK2 | 16 | - | - | 1 | 17 | 5 |
| GJITHSEJ | 249 | 597 | 8 | 75 | 929 | 137 |

Gjendja e lëndëve sipas kërkesave për mbrojtjen e ligjshmërisë – KZZ të parashtruara nga ana e Prokurorisë themelore publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, që kanë qenë në

procedurë në Sektorin e veprave penale dhe që kanë të bëjnë me gjykatat themelore dhe të apelit është shfaqur në **tabelën nr.5.**

Tabela 5

Viti 2020 KZZ – pasqyra e lëndëve të kryera sipas gjykatave

| Gjykata e apelit | Gjykata themelore dhe numri i lëndëve | Kërkesë e refuzuar | TË APROVUARA | | | | | | | Të kryera | Të pa kryera |
|--|--|--------------------|------------------------|---------------------------|-------------------------------|-------------|----------------------|-------------------|------------------------------------|-----------|--------------|
| | | | I abroguar aktgjykim i | I abroguar aktgjykim i II | I abroguar aktgjykim i dhe II | Cenimi i KP | Aktgjykimet me lirim | Të hedhura poshtë | Të ndryshuara ose në tjetër mënyrë | | |
| Shkup 8 lëndë | Gjykata themelore penale-6 Gjykata themelore Veles-2 | 2 | - | 1 | 3 | - | - | 2 | - | 8 | - |
| Manastir 4 lëndë | Gjykata themelore Ohër-1 Gjykata themelore Manastir-1 Gjykata themelore Strugë-2 | - | - | - | 1 | - | - | 1 | - | 2 | 2 |
| Shtip 9 lëndë | Gjykata themelore Strumicë-2 Gjykata themelore Koçanë-3 Gjykata themelore S. Nikolë-1 Gjykata themelore Shtip-1 Gjykata themelore Vinicë-1 Gjykata themelore Berovë-1 | 2 | - | - | 1 | 3 | - | - | - | 6 | 3 |
| Gostivar 4 lëndë | Gjykata themelore Tetovë-2 Gjykata themelore Gostivar-1 Gjykata themelore Kërçovë-1 | 1 | - | 2 | 1 | - | - | - | - | 4 | - |
| Gjithsej lëndë në punë: 25 Gjithsej lëndë të kryera: 20 | | 5 | - | 3 | 6 | 3 | - | 3 | - | 20 | 5 |

| 1 person | 2 persona | 3 persona | 4 persona | 6 persona | Gjithsej persona të akuzuar |
|----------|-----------|-----------|-----------|-----------|-----------------------------|
| 12 lëndë | 4 lëndë | 1 lëndë | 2 lëndë | 1 lëndë | 20 |

Dukshëm nga **tabela 5**, nga gjithsej **20** kërkesat e kryera, **5** janë të refuzuara si të pabaza. Nga **12** lëndët e aprovuara: në **3** lëndë është abroguar vetëm aktgjykimi i shkallës së dytë, në **6** lëndë është abroguar aktgjykimi i shkallës së parë dhe të dytë, në **3** lëndë është konstatuar cenimi i KP, **3** lëndë janë hedhur poshtë, ndërsa të pa kryera kanë mbetur gjithsej **5** lëndë.

Sipas rajonit të apeleve gjendja e lëndëve të kryera apo të pa kryera është si vijon: **8** lëndë nga Gjykata e apelit Shkup, dhe të gjitha janë të kryera, **4** lëndë nga Gjykata e apelit Manastir, nga të cilat **2** janë të kryera e **2** janë të pa kryera, **9** lëndë nga Gjykata e apelit Shtip, nga të cilat **6** janë të kryera dhe **3** janë të pa kryera, **4** lëndë nga Gjykata e apelit Gostivar dhe të gjitha janë të kryera. Me një person të dënuar ka pasur **12** lëndë, me dy persona **4** lëndë, me tre persona **1** lëndë, me katër persona **2** lëndë dhe me **6** persona **1** lëndë, ose gjithsej **20** persona të dënuar.

Gjendja e lëndëve në procedurë të shkallës së tretë – **VKZH1** për ankesa të aktvendimeve për paraburgim dhe për ankesa të aktgjykimeve të Gjykatave të apelit është shfaqur në **tabelat në vijim**:

VKZH1 – ankesa të aktvendimeve për paraburgim

| Numri i lëndëve të pranuar në vitin 2020 | Kanë mbetur nga muaji 12 të vitit 2019 | Gjithsej në punë | Të hedhura poshtë | Të refuzuara | Të aprovuara | Në tjetër mënyrë | Të kryera | Të pa kryera |
|--|--|------------------|-------------------|--------------|--------------|------------------|-----------|--------------|
| 56 | - | 56 | 3 | 46 | 3 | - | 52 | 4 |
| Gjithsej: 56 | - | 56 | 3 | 46 | 3 | - | 52 | 4 |

VKZH2 – ankesa të aktgjykimeve në shkallë të tretë

| Numri i lëndëve të pranuar në vitin 2020 | Kanë mbetur nga muaji 12 i vitit 2019 | Gjithsej në punë | Të hedhura poshtë | Të refuzuara | Të aprovuara | Në tjetër mënyrë | Të kryera | Të pakryera |
|--|---------------------------------------|------------------|-------------------|--------------|--------------|------------------|-----------|-------------|
| 48 | 23 | 71 | 14 | 30 | 15 | 1 | 60 | 11 |
| Gjithsej: 48 | 23 | 71 | 14 | 30 | 15 | 1 | 60 | 11 |

Sipas ankesave të aktvendimeve për paraburgim – **VKZH1** në vitin 2020 janë pranuar **56** lëndë, nga të cilat në **46** lëndë ankesa është refuzuar si e pabazë, në **3** lëndë ankesat janë të aprovuara, në **3** lëndë ankesat janë të hedhura poshtë, ndërsa kanë mbetur të pakryera **4** lëndë.

Sipas ankesave të aktgjykimeve në shkallë të tretë – **VKZH2** në vitin 2020 janë pranuar **48** lëndë, **23** lëndë kanë mbetur nga viti 2019, ose gjithsej në punë kanë qenë **71** lëndë, nga të cilat **30** lëndë janë të refuzuara, **15** lëndë janë të aprovuara, **14** lëndë janë të hedhura poshtë, **1** lëndë është kryer në tjetër mënyrë, ndërsa kanë mbetur të pakryera **11** lëndë.

Gjendja e lëndëve për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit – **VUK** është si vijon:

Nga viti 2019 kanë mbetur të pa kryera **8** lëndë, në vitin 2020 janë pranuar **21** lëndë të reja, gjithsej në punë kanë qenë **29** lëndë, nga të cilat të kryera janë **27** lëndë, ndërsa kanë mbetur të pa kryera **2** lëndë. Sipas llojit të vendimit: **23** lëndë janë refuzuar, **1** lëndë e aprovuar, **2** lëndë të hedhura poshtë dhe në tjetër mënyrë është kryer **1** lëndë.

Gjendja e lëndëve të evidentuara si **KR**, ku Gjykata supreme e Republikës së Maqedonisë miraton vendime për ndeshje të kompetencave, për bartjen e kompetencës vendore dhe reale, për parashtrësat e parashtruara nga ana e paditësit në mënyrë subsidijare (plotësuese), për kërkesa të parashtruara për ekstradim, për kërkesa për parashkrim në procedurë për kundërvajtje, për kërkesa të parashtruara për kthimin në procedurë paraprake dhe të tjera, është si vijon:

Nga viti 2019 kanë mbetur **6** lëndë të pa kryera, në vitin 2020 janë pranuar **620** lëndë të reja, gjithsej në punë kanë qenë **626** lëndë, nga të cilat **573** lëndë të kryera, ndërsa kanë mbetur të pa kryera **53** lëndë. Sipas llojit të vendimit: **10** lëndë janë të refuzuara, **552** lëndë janë të aprovuara, **5** lëndë janë të hedhura poshtë dhe **6** lëndë në tjetër mënyrë.

Kohëzgjatja e procedurës së lëndëve sipas bazave

Kohëzgjatja e procedurës së lëndëve, në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut nga pranimi i lëndëve në Sektorin e veprave penale deri në kryerjen dhe ekspedimin e tyre është shfaqur në **tabelën nr. 6**.

Zgjatja e procedurës për SEKTORIN e veprave penale

| Regjistri | Gjithsej në punë | Të kryera | Deri në 1 muaj | Deri në 2 muaj | Deri në 3 muaj | Deri në 4 muaj | Deri në 5 muaj | Deri në 6 muaj | Deri në 7 muaj | Deri në 8 muaj | Deri në 9 muaj | Deri në 10 muaj | Deri në 11 muaj | Deri në 12 muaj | Më shumë se 1 vjet | Të pa kryera |
|--|------------------|-----------|----------------|----------------|----------------|----------------|----------------|----------------|----------------|----------------|----------------|-----------------|-----------------|-----------------|--------------------|--------------|
| Regjistri i kërkesave për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit | 29 | 27 | 4 | 4 | 6 | 2 | 3 | 2 | 2 | | | 1 | | 1 | 2 | 2 |
| Regjistri për shqyrtimin e jashtëzakonshëm të vendimit të plotfuqishëm - 3 | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Regjistri për shqyrtimin e jashtëzakonshëm të vendimit të plotfuqishëm – 5 | 237 | 180 | 11 | 19 | 23 | 18 | 13 | 10 | 5 | 9 | 9 | 10 | 4 | 8 | 41 | 57 |
| Regjistri për shqyrtimin e jashtëzakonshëm të vendimit të plotfuqishëm – krim i organizuar - 3 | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Regjistri për shqyrtimin e jashtëzakonshëm të vendimit të plotfuqishëm – krim i organizuar – 5 | 22 | 17 | | 2 | 2 | 2 | | 1 | | 1 | | 1 | 2 | 1 | 5 | 5 |
| Regjistri i ankesave të aktvendimeve të paraburgimit | 56 | 52 | 52 | | | | | | | | | | | | | 4 |
| Regjistri i ankesave të aktgjyqimeve në shkallë të tretë | 71 | 60 | 8 | 6 | 7 | 4 | 7 | 6 | 4 | 4 | 4 | 4 | 2 | 1 | 3 | 11 |
| Regjistri i lëndëve të ndryshme penale | 626 | 573 | 249 | 294 | 20 | 1 | 2 | 2 | 2 | 2 | | | | | 1 | 53 |
| Regjistri i kërkesave për mbrojtjen e ligjshmërive të lëndëve penale | 25 | 20 | 1 | 1 | | 1 | 2 | 3 | 1 | 2 | 3 | 1 | 1 | 1 | 3 | 5 |
| GJITHSEJ | 1066 | 929 | 325 | 326 | 58 | 28 | 27 | 24 | 14 | 18 | 16 | 17 | 9 | 12 | 55 | 137 |

Në vitin 2020, siç rrjedh edhe nga tabela e kohëzgjatjes së procedurës, sipas numrit të ndarë të lëndëve nuk ka qenë e mundshme të veprohet menjëherë për shkak të pengesave administrative, të cilat është dashur të tejkalohen (sigurimi i shkresave, mungesa e shkresave origjinale, rregullimi i dorëzimit të aktgjykimit të shkallës së dytë drejtuar të akuzuarit, prova të dorëzuara në fotokopje, dorëzimi në Prokurorinë publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të ngjashme).

Disa lëndë, në Gjykatë janë dorëzuar me shkresa të pa kompletuara, dhe ka qenë e nevojshme që në mënyrë administrative të kthehen në gjykatat ose në Prokurorinë publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, që shkakton angazhim plotësues të gjyqtarëve referues për kompletimin e lëndëve.

SEANCA TË SEKTORIT

Në Sektorin e veprave penale, gjatë vitit 2020 janë mbajtur disa seanca të Sektorit, në të cilat është shqyrtuar për çështje juridike, iniciativa dhe kërkesa të parashtruara nga gjykatat themelore dhe të apeleve, si dhe nga avokatë, për të cilat janë nxjerrë konkluzione, dhe po ashtu janë miratuar edhe shumë konkluzione që kanë të bëjnë me unifikimin e procedimit në këtë Sektor.

SEKTORI I VEPRAVE CIVILE

Në Sektorin e veprave civile, gjatë vitit 2020 sipas Vendimit për Orarin vjetor të punës së gjyqtarëve dhe administratës gjyqësore të datës 30.12.2019 dhe Vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për Orarin vjetor të punës të datës 16.01.2020 janë sistemuar 12 (dymbëdhjetë) gjyqtarë, të cilët sipas lëndëve nga të gjitha llojet kanë vendosur në tre këshilla, ndërsa me Vendimet për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për Orarin vjetor të punës të datës 18.03.2020 dhe datës 26.06.2020, në këtë Sektor janë sistemuar 15 (pesëmbëdhjetë) gjyqtarë në tre këshilla, si edhe më parë, deri në fund të vitit raportues.

Në këtë Sektor, janë sistemuar sekretar dhe zëvendës sekretar të Sektorit nga radha e bashkëpunëtorëve profesional gjyqësorë, bashkëpunëtorëve profesional gjyqësorë, të cilët kanë punuar sipas të gjitha llojeve të lëndëve, ndërsa në sportelin e Sektorit janë caktuar Udhëheqës i sportelit dhe dy referentë gjyqësorë për kryerjen e punëve administrative.

Struktura e lëndëve

Nga treguesit numëror për vitin 2020, në Sektorin e veprave civile në punë ka pasur gjithsej 1.873 lëndë, nga të cilat 918 lëndë kanë mbetur të pa kryera nga viti 2019, 2018 dhe 2017, ndërsa të reja të pranuar janë 955 lëndë.

Në krahasim me vitin 2019 kur janë pranuar 1.185 lëndë, rritja e numrit të lëndëve të reja në vitin 2020 është zvogëluar për 230 lëndë, respektivisht janë pranuar 955 lëndë. Në vitin raportues, janë kryer 1.233 lëndë, ndërsa të pa kryera kanë mbetur 918 lëndë.

| Sfera | Sfera civile | | | | | | |
|--|-------------------------------|--------------------|-----------------|--------------------------|------------------|-------------|-------------|
| Lloji i lëndës | | | | | | | |
| Nënloji i lëndës | Të pa kryera | Të reja të pranuar | Përsëri në punë | Të evidentuara gabimisht | Gjithsej në punë | Të kryera | Kanë mbetur |
| Lëndë të ndryshme civile dhe ndeshje të kompetencave të ndryshme | 15 | 134 | 0 | 2 | 147 | 134 | 13 |
| Gjithsej – lloji i lëndës | 15 | 134 | 0 | 2 | 147 | 134 | 13 |
| Lloji i lëndës | Lëndë civile sipas revizionit | | | | | | |
| Nënloji i lëndës | Të pa kryera | Të reja të pranuar | Përsëri në punë | Të evidentuara gabimisht | Gjithsej në punë | Të kryera | Kanë mbetur |
| Konteste tregtare – revizion | 226 | 155 | 1 | 0 | 382 | 245 | 137 |
| Konteste pune – revizion | 194 | 189 | 0 | 0 | 383 | 277 | 106 |
| Konteste civile – revizion | 483 | 477 | 2 | 1 | 961 | 577 | 384 |
| Gjithsej – lloji i lëndës | 903 | 821 | 3 | 1 | 1726 | 1099 | 627 |
| Gjithsej - sfera | 918 | 955 | 3 | 3 | 1873 | 1233 | 640 |

Krahasuar me vitin 2019, kur kanë qenë të kryera 1.211 lëndë, në vitin raportues janë kryer 22 lëndë më tepër, respektivisht 1233 lëndë. Numri i lëndëve të pa kryera, në vitin 2019 dhe vitin 2020 është i njëjtë, respektivisht kanë mbetur 918 lëndë të pa kryera.

Në vitin 2020, në Sektorin e veprave civile rritja e numrit të lëndëve të reja është tejkaluar, respektivisht në vitin 2020, janë pranuar gjithsej 955 lëndë ndërsa janë kryer gjithsej 1.233 lëndë, ashtu që numri i lëndëve të pa kryera është zvogëluar për 278 lëndë.

Struktura e 1233 lëndëve të kryera është si vijon: nga Regjistri Rev1 – janë kryer 245 lëndë; nga Regjistri Rev2 – janë kryer 577 lëndë; nga Regjistri Rev3 – janë kryer 277 lëndë; nga Regjistri R – janë kryer 134 lëndë.

Struktura e 918 lëndëve të pa kryera është si vijon: 1 lëndë ka mbetur e pa kryer nga viti 2017 nga Regjistri Rev2, për shkak se është ndërprerë procedura e revizionit, nga viti 2018 kanë mbetur 2 lëndë të pa kryera nga Regjistri Rev1 për shkak të përsëritjes së procedurës në gjykatat e ulëta, nga viti 2019 kanë mbetur 97 lëndë të pa kryera, nga të cilat 37 lëndë nga Regjistri Rev1, 45 lëndë nga Regjistri Rev2 dhe 15 lëndë nga Regjistri Rev3. 540 lëndë që kanë mbetur të pa kryera janë nga viti 2020 edhe atë nga Regjistri Rev1 – 98 lëndë të pa kryera, nga Regjistri Rev2 – 338 lëndë dhe nga Regjistri Rev3 kanë mbetur të pa kryera 91 lëndë. Të evidentuara gabimisht janë 3 lëndë, dhe 3 lëndë të cilat kanë qenë përsëri në punë.

| Lëndë të pa kryera sipas vitit të pranimit | Të pranuar në vitin 2017 | Të pranuar në vitin 2018 | Të pranuar në vitin 2019 | Të pranuar në vitin 2020 | Gjithsej |
|--|--------------------------|--------------------------|--------------------------|--------------------------|----------|
| Regjistri i lëndëve civile sipas revizionit | 1 | | 45 | 338 | 384 |
| Regjistri i kontesteve tregtare sipas revizionit | | 2 | 37 | 98 | 137 |
| Regjistri i lëndëve të ndryshme civile | | | | 13 | 13 |
| Regjistri i kontesteve të punës sipas revizionit | | | 15 | 91 | 106 |
| Gjithsej | 1 | 2 | 97 | | 640 |

Rezultatet e arritura, i nënshtrohen angazhimit të madh për kryerjen e më shumë lëndëve dhe rritjen e numrit të gjyqtarëve referues, që ishte i rritur në krahasim me vitin e kaluar 2019, edhe pse të gjithë gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët profesional gjyqësor kanë vepruar me lëndë edhe nga materie tjera. Krahasuar me vitet e kaluara, mund të nxirret konkluzion se është zvogëluar vëllimi i punës si rezultat i zvogëlimit të numrit të lëndëve të reja të pranuar, ashtu që në vitin 2016 janë pranuar 1.270 lëndë, në vitin 2017 janë pranuar 1.225 lëndë, në vitin 2018 janë pranuar 1204 lëndë, në vitin 2019 janë pranuar 1185 lëndë dhe në vitin raportues janë pranuar 955 lëndë. Mund të jepet përfundim se në rritjen e lëndëve të kryera, që është rezultat i numrit të gjyqtarëve, të cilët kanë vepruar me këtë lloj të lëndëve, respektivisht me caktimin edhe të dy gjyqtarëve të zgjedhur në këtë gjykatë në vitin 2020, në Sektorin e veprave civile dhe me caktimin edhe të një gjyqtari i cili deri atëherë ka ushtruar funksionin jashtë gjykatës. Nga analiza e periudhës së kaluar pesëvjeçare, mund të arrihet në përfundimin se, në vitin raportues është më i ulët numri i lëndëve që kanë mbetur të pa kryera dhe i njëjti numëron 640 lëndë.

Mënyra e kryerjes së lëndëve

Procedura e revizionit si mjet i jashtëzakonshëm juridik, shfrytëzohet nga palët për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tyre. Nga numri **1873** i gjithsej lëndëve civile që kanë qenë në punë në vitin 2020, sipas revizionit ka pasur **1.726** lëndë, nga të cilat nga Regjistri **Rev1 – 382** lëndë, nga Regjistri **Rev2 – 961** lëndë dhe nga Regjistri **Rev3 – 383** lëndë, respektivisht sipas revizionit ka pasur **92,15%** nga gjithsej numri i lëndëve ndërsa prej tyre, revizione të kryera ka pasur **1099** lëndë, respektivisht 63,67%.

| Lloji i lëndës | Lëndë civile sipas revizionit | | | | | | |
|----------------------------------|-------------------------------|--------------------|-----------------|--------------------------|------------------|-------------|-------------|
| Nënllloji i lëndës | Të pakryera | Të reja të pranuar | Përsëri në punë | Të evidentuara gabimisht | Gjithsej në punë | Të kryera | Kanë mbetur |
| Konteste tregtare – revizion | 226 | 155 | 1 | 0 | 382 | 245 | 137 |
| Konteste pune – revizion | 194 | 189 | 0 | 0 | 383 | 277 | 106 |
| Konteste civile – revizion | 483 | 477 | 2 | 1 | 961 | 577 | 384 |
| Gjithsej – lloji i lëndës | 903 | 821 | 3 | 1 | 1726 | 1099 | 627 |

Nga numri i 1099 lëndëve të kryera, përmbajtja e vendimeve të revizionit duket kështu: të refuzuara 643 respektivisht 58,51%, të ndryshuara 64 respektivisht 5,82%, të abroguara 149 respektivisht 13,56%, të hedhura poshtë 242 respektivisht 22,02%. Sipas numrit të revizioneve të refuzuara krahasuar me vitet e kaluara, të dhënat janë kështu: në vitin 2017- 58,84, në vitin 2018 - 62,37%, në vitin 2019 – 56,30% dhe në vitin 2020 – 58,50%. Nga këto numra, duket se përqindja e revizioneve, të cilat janë të refuzuara në vitin 2020 krahasuar me vitin e kaluar, dukshëm është rritur.

| Gjykata | Të hedhura poshtë | Të refuzuara | Të ndryshuara | Të abroguara | Të kryera në tjetër mënyrë | Gjithsej |
|-----------------|-------------------|--------------|---------------|--------------|----------------------------|-------------|
| Manastir | 113 | 398 | 38 | 73 | 1 | 622 |
| Shtip | 57 | 123 | 15 | 32 | | 227 |
| Gostivar | 24 | 60 | 7 | 16 | | 107 |
| Administrative | 39 | 60 | 4 | 28 | | 131 |
| Gjithsej | 242 | 643 | 64 | 149 | 1 | 1099 |

Gjendja në gjykatat e apelit lidhur me revizionet e refuzuara në vitin 2020, është kështu:

| Gjykata | Gjithsej revizione të kryera | Revizione të refuzuara | Përqindja e revizioneve të refuzuara |
|----------|------------------------------|------------------------|--------------------------------------|
| Shkup | 622 | 398 | 63,99 |
| Manastir | 227 | 123 | 54,18 |
| Shtip | 107 | 60 | 56,08 |
| Gostivar | 131 | 60 | 45,80 |

| | | | |
|-----------------------|------|-----|-------|
| Administrative | 9 | 1 | 11,11 |
| Gjithsej | 1099 | 643 | 58,51 |

Ndryshimi i vendimeve të hedhura poshtë, ndodh kur gjendja faktike është konstatuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, ndërsa e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të gabuar. Nëse krahasohen numrat e viteve të fundit, gjendja është si vijon: në vitin 2017 ka pasur 82 lëndë të ndryshuara, respektivisht 6,74%, në vitin 2018 – 83 lëndë respektivisht 6,99%, në vitin 2019 kanë qenë 85 lëndë të ndryshuara, respektivisht 8,62% dhe në vitin 2020 kanë qenë 64 lëndë të ndryshuara respektivisht 5,82%. Këto numra, tregojnë se vendimet gjyqësore të ndryshuara në vitin e fundit dukshëm janë zvogëluar në krahasim me vitin e kaluar raportues, respektivisht nuk ka ndryshime të konsiderueshme të rezultateve të gjykatave të apelit, që kanë të bëjnë me këtë pjesë të punës në krahasim me vitin e kaluar.

Gjendja e gjykatave të apelit, sa i përket revizioneve të abroguara me vendime të ndryshuara, në vitin 2020 është si vijon:

| Gjykata | Gjithsej revizione të kryera | Vendime të ndryshuara | Përqindja e revizioneve të ndryshuara |
|-----------------------|-------------------------------------|------------------------------|--|
| Shkup | 622 | 38 | 6,10 |
| Manastir | 227 | 15 | 6,61 |
| Shtip | 107 | 7 | 6,54 |
| Gostivar | 131 | 4 | 3,05 |
| Administrative | 9 | / | / |
| Gjithsej | 1099 | 64 | 5,82 |

Gjendja e gjykatave të apelit, sa i përket revizioneve të aprovuara me vendime të abroguara në vitin 2020, është si vijon:

| Gjykata | Gjithsej revizione të kryera | Vendime të abroguara | Përqindja e vendimeve të abroguara |
|-----------------------|-------------------------------------|-----------------------------|---|
| Shkup | 622 | 73 | 11,74 |
| Manastir | 227 | 32 | 14,10 |
| Shtip | 107 | 16 | 14,95 |
| Gostivar | 131 | 28 | 21,38 |
| Administrative | 9 | / | / |
| Gjithsej | 1099 | 149 | 13,56 |

Gjendja e gjykatave të apelit, sa i përket revizioneve të hedhura poshtë, në vitin 2020 është si vijon:

| Gjykata | Gjithsej revizione të kryera | Revizione të hedhura poshtë | Përqindja e revizioneve të hedhura poshtë |
|----------------|------------------------------|-----------------------------|---|
| Shkup | 622 | 113 | 18,17 |
| Manastir | 227 | 57 | 25,11 |
| Shtip | 107 | 24 | 22,43 |
| Gostivar | 131 | 39 | 29,77 |
| Administrative | 9 | 8 | 88,88 |
| Gjithsej | 1099 | 242 | 22,02 |
| | | | |

Procedura tjera

Sektori i veprave civile përveç mjeteve të jashtëzakonshme, vendos edhe për lëndë të tjera nga kompetenca e tij. Ato janë lëndë për ndeshje të kompetencave, përcaktim i tjetër gjykate reale kompetente, vazhdimin e afatit për parashtrim të padisë për kontestimin e atësisë, nga të cilat në punë kanë qenë gjithsej 147 lëndë dhe nga ato, të kryera janë 134 lëndë, ose 91,16%, kurse të pa kryera kanë mbetur 15 ose 10,20%.

| Nënloji i lëndës | Të pa kryera | Të reja të pranuar | Përsëri në punë | Të evidentuara Gabimisht | Gjithsej në punë | Të kryera | Kanë mbetur |
|--|--------------|--------------------|-----------------|--------------------------|------------------|-----------|-------------|
| Lëndë të ndryshme civile dhe ndeshje të ndryshme të kompetencave | 15 | 134 | 0 | 2 | 147 | 134 | 13 |
| Gjithsej – lloji i lëndës | 15 | 134 | 0 | 2 | 147 | 134 | 13 |

Struktura e lëndëve sipas bazave juridike

Dukshëm nga bazat juridike të revizioneve, për të cilat është vendosur në Sektorin e veprave civile gjatë vitit 2020, mund të konstatohet ndryshueshmëri. Të shumta janë lëndët me bazë për kompensim të dëmit – 287 lëndë ose 26,11%; pastaj me bazë konteste pune – 266 lëndë ose 24,20%; borxhi – 189 lëndë ose 17,20%; për pronësi dhe zotërimi 166 lëndë ose 15,10%; shfuqizimi dhe ndërprerja e marrëveshjes – 75 lëndë ose 6,82%, për asistencë – 36 lëndë ose 3,28%; për arritje pa bazë – 38 lëndë ose 3,46%; për falimentim – 29 lëndë ose 2,64%, konteste tjera – 7 lëndë ose 0,64% dhe të drejtat e autorit dhe pronësia industriale – 6 ose 0,55%.

Krahasuar me vitin e kaluar, në vitin 2019 ka dallim në numrin e revizioneve, për të cilat është marrë vendim sipas bazave në vijim: Është zvogëluar numri i vendimeve të kryera në vitin

2019 krahasuar me vitin 2018 sipas bazave në vijim: për borxh në vitin 2019 janë kryer 189 lëndë; kurse në vitin 2018 – 229 lëndë; pronësia në vitin 2019 janë kryer 166 lëndë, kurse në vitin 2018 - 189 lëndë;. Është rritur numri i lëndëve të kryera në krahasim me vitin e kaluar sipas bazës për të drejtat e autorit, respektivisht në vitin 2019 janë kryer 7 lëndë kurse në vitin 2018 janë kryer 3 lëndë dhe për pronësia dhe zotërimi në vitin 2019 janë kryer 189 lëndë për derisa në vitin 2018 janë kryer 118 lëndë. sipas bazave të tjera – asistenca, arritja pa bazë nuk është vërejtur dallim shumë i madh në numrin e revizioneve, për të cilat është marrë vendim në vitin raportues krahasuar me vitin e kaluar 2018.

| Baza | 2019 | 2020 |
|--|------|------|
| Asistenca | 38 | 36 |
| Kompensim i dëmit | 279 | 287 |
| Arritja pa bazë | 36 | 38 |
| Shfuqizimi dhe ndërprerja e marrëveshjes | 50 | 75 |
| Borxhi | 229 | 189 |
| Pronësia dhe zotërimi | 189 | 166 |
| Konteste pune | 109 | 266 |
| Falimentim | 34 | 29 |
| Të drejtat e autorit | 7 | 6 |
| Baza tjera | 15 | 7 |
| Gjithsej | | 1099 |

Zgjatja e procedurës

Në vitin 2020, nga gjithsej 1.233 lëndët e kryera, zgjatje të procedurës me mbi tre vjet nuk ka pasur lëndë të pa kryera; nga 1 deri në 3 vjet ka pasur 510 lëndë; nga 8 muaj deri në 1 vjet ka pasur 247 lëndë; nga 6 deri në 8 muaj ka pasur 77 lëndë; nga 3 deri në 6 muaj ka pasur në 217 lëndë; nga 2 deri në 3 muaj në 58 lëndë, nga 1 deri në 2 muaj në 71 lëndë, deri në 1 muaj procedura ka zgjatur në 53 lëndë.

| Zgjatja e procedurës | Të kryera | Deri në 1 muaj | Nga 1 deri në 2 muaj | Nga 2 deri në 3 muaj | Nga 3 deri në 6 muaj | Nga 6 deri në 8 muaj | Nga 8 deri në 1 vjet | Nga 1 deri në 3 vjet | Mbi 3 vjet |
|--|-----------|----------------|----------------------|----------------------|----------------------|----------------------|----------------------|----------------------|------------|
| Regjistri i lëndëve civile të revizionit | 577 | 2 | 17 | 16 | 100 | 45 | 142 | 255 | |
| Regjistri i kontesteve tregtare të revizionit | 277 | | 2 | 9 | 74 | 16 | 47 | 129 | |
| Regjistri i lëndëve të ndryshme civile të revizionit | 134 | 49 | 44 | 24 | 14 | 2 | 1 | | |
| Regjistri i kontesteve të punës të revizionit | 245 | 2 | 8 | 9 | 29 | 14 | 57 | 126 | |
| Gjithsej | 1233 | 53 | 71 | 58 | 217 | 77 | 247 | 510 | |

Siç duket, për një pjesë bukur të mirë të lëndëve, procedura në këtë gjykatë ende zgjat në mënyrë relative, edhe pse pa diskutim ky trend krahasuar me vitet e kaluara ka përmirësime.

SEANCA E SEKTORIT

Në vitin 2020, Sektori i veprave civile mbajti 4 (katër) seanca. Në këto seanca, është shqyrtuar për çështje të ndryshme juridike të cilat buronin nga lëndët, 8 (tetë) çështje juridike dhe çështje të parashtruara nga gjykatat themelore dhe të apelit dhe parashtrues të tjerë, për të cilat janë konstatuar 4 (katër) mendime juridike, të cilat janë të publikuara në faqen zyrtare dhe 6 (gjashtë) sentenca të konstatuara dhe të publikuara. Në Sektorin e veprave civile, është vepruar për 78 (shtatëdhjetë e tetë) lëndë të ndryshme civile, të evidentuara me shenjë Gr për çështje të parashtruara juridike. Duke marrë parasysh gjendjen e pandemisë së shkaktuar me virusin Kovid 19, në vitin raportues sipas protokolleve janë mbajtur më pak seanca të Sektorit dhe nuk janë realizuar mbledhjet e planifikuara të përbashkëta me gjykatat e apelit.

SEKTORI PËR GJYKIM TË ARSYESHËM

Në Sektorin për gjykim në afat të arsyeshëm, gjatë vitit 2020 sipas Vendimit për Orarin vjetor të punës së gjyqtarëve dhe të administratës gjyqësore të datës 30.12.2019, funksionin e gjyqtarit e realizuan 12 (dymbëdhjetë) gjyqtarë, me Vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për Orarin vjetor të datës 16.01.2020, janë sistemuar 16 (gjashtëmbëdhjetë) gjyqtarë kurse me Vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Orarit vjetor të punës të datës **15.09.2020** janë sistemuar 17 (shtatëmbëdhjetë) gjyqtarë deri në fund të vitit raportues.

Në këtë Sektor, janë sistemuar Sekretar dhe Zëvendësi i sekretarit nga radha e bashkëpunëtorëve gjyqësor profesional, bashkëpunëtorëve profesional gjyqësor, të cilët kanë vepruar sipas të gjitha llojeve të lëndëve dhe Udhëheqës i sportelit të Sektorit për kryerjen e çështjeve administrative.

Pasqyra totale e punës së lëndëve

Sektori për gjykim në afat të arsyeshëm, gjatë vitit raportues **2020**, gjithsej në punë ka pasur **548** lëndë, në të dyja shkallët për vendimmarrje, nga të cilët **361** janë lëndë **të reja të pranuar**, ndërsa nga periudha e kaluar raportuese kanë mbetur **të pakryera 177** lëndë, ndërsa **10** lëndë kanë qenë përsëri në punë. Gjatë vitit raportues **janë kryer 392** lëndë, ndërsa **156** lëndë **kanë mbetur të pa kryera**.

Në **këshillat e shkallës së parë**, në punë kanë qenë **388** lëndë, nga të cilët **233** lëndë të reja të pranuar, kurse **146** lëndë kanë mbetur të pakryera nga periudha e kaluar raportuese, derisa **9** lëndë kanë qenë përsëri në punë. Këshillat e shkallëve të parë kanë kryer **270** lëndë, përderisa **118** lëndë kanë mbetur të pa kryera.

Këshilli i shkallës së dytë, ka pasur gjithsej **160** lëndë në punë nga të cilët **128** lëndë të reja të pranuar, **31** lëndë kanë mbetur të pa kryera nga viti i kaluar, ndërsa **1** lëndë ka qenë përsëri në punë. Në fund të periudhës raportuese, këshilli i shkallës së dytë – për ankesa, ka kryer **122** lëndë, përderisa të pa kryera kanë mbetur **38** lëndë.

Tabela e shfaqur e numrit të lëndëve në këtë Sektor, për vitin 2020

Tabela 2

| Sfera | Gjykim në afat të arsyeshëm | | | | | | |
|--|---|--------------------|-----------------|--------------------------|------------------|------------|-------------|
| Lloji i lëndës | Gjykim në afat të arsyeshëm – të shkallës së parë | | | | | | |
| Nënloji i lëndës | Të pa kryera | Të reja të pranuar | Përsëri në punë | Të evidentuara gabimisht | Gjithsej në punë | Të kryera | Kanë mbetur |
| Gjykim në afat të arsyeshëm - Administrative | 68 | 93 | 3 | 0 | 164 | 102 | 62 |
| Gjykim në afat të arsyeshëm – Penale | 45 | 49 | 3 | 0 | 97 | 66 | 31 |
| Gjykim në afat të arsyeshëm – Civile | 33 | 91 | 3 | 0 | 127 | 102 | 25 |
| Gjithsej – lloji i lëndës | 146 | 233 | 9 | 0 | 388 | 270 | 118 |
| Lloji i lëndës | Gjykim në afat të arsyeshëm - të shkallës së dytë | | | | | | |
| Nënloji i lëndës | Të pa kryera | Të reja të pranuar | Përsëri në punë | Të evidentuara gabimisht | Gjithsej në punë | Të kryera | Kanë mbetur |
| Gjykim në afat të arsyeshëm – ankesa | 31 | 128 | 1 | 0 | 160 | 122 | 38 |
| Gjithsej – lloji i lëndës | 31 | 128 | 1 | 0 | 160 | 122 | 38 |
| Gjithsej – sfera | 177 | 361 | 10 | 0 | 548 | 392 | 156 |

Nga numri i gjithsej **392 lëndëve në periudhën raportuese**, në **195 lëndë** – kërkesa për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm **është refuzuar** si e pabazë, në **144 lëndë** – kërkesa për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm **është aprovuar**, përderisa në **53 lëndë** – kërkesa për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm **është hedhur poshtë**.

Mënyra e vendimmarrjes – afat të arsyeshëm, viti 2020

| Tituj | Të pa kryera nga periudha e kaluar | Të reja të pranuar | Gjithsej në punë | Të kryera | Të hedhura poshtë | Të refuzuara | Të aprovuara | Në tjetër mënyrë | Të pakryera në fund të periudhës |
|-----------------|------------------------------------|--------------------|------------------|------------|-------------------|--------------|--------------|------------------|----------------------------------|
| PSRRG | 33 | 94 | 127 | 102 | 22 | 46 | 34 | | 25 |
| PSRRK | 45 | 52 | 97 | 66 | 11 | 21 | 34 | | 31 |
| PSRRU | 68 | 96 | 164 | 102 | 17 | 37 | 48 | | 62 |
| PSRRZH | 31 | 129 | 160 | 122 | 3 | 91 | 28 | | 38 |
| GJITHSEJ | 177 | 371 | 548 | 392 | 53 | 195 | 144 | | 156 |

Pasqyra totale e punës së lëndëve, të këshillave të shkallës së parë

Gjatë vitit **2020**, këshillat e shkallës së parë, në këtë Sektor kanë pasur në punë **388 lëndë** ose **70,80%** nga gjithsej **548 lëndë**.

Numrin total të **388 lëndëve** e përbëjnë **242 lëndë** të reja të pranuar dhe **146 lëndë** që kanë mbetur të pa kryera nga periudha e kaluar raportuese. Në këshillat e shkallës së parë, janë kryer gjithsej **270 lëndë** ose **69,58%**, kurse të pa kryera në fund të vitit raportues kanë mbetur **118 lëndë** ose **30,41%**.

Mënyra e vendimmarrjes - afat të arsyeshëm shkalla e I, viti 2020

| Tituj | Të pa kryera nga periudha e kaluar | Të reja të pranuar | Gjithsej në punë | Të kryera | Të hedhura poshtë | Të refuzuara | Të aprovuara | Në tjetër mënyrë | Të pa kryera në fund të periudhës |
|-----------------|------------------------------------|--------------------|------------------|-----------|-------------------|--------------|--------------|------------------|-----------------------------------|
| PSRRU | 68 | 96 | 164 | 102 | 17 | 37 | 48 | | 62 |
| PSRRK | 45 | 52 | 97 | 66 | 11 | 21 | 34 | | 31 |
| PSRRG | 33 | 94 | 127 | 102 | 22 | 46 | 34 | | 25 |
| GJITHSEJ | 146 | 242 | 388 | 270 | 50 | 104 | 116 | | 118 |

Nga gjithsej **270 lëndët e kryera** në këshillat e shkallës së parë, mund të konstatojmë se mbizotëron numri i lëndëve të kryera me aprovimin e kërkesës dhe konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm në **116 lëndë ose 42,96%**. Nga lëndët, të cilat janë kryer me **aprovimin** e kërkesës për mbrojtjen e të drejtës së gjykimit në afat të arsyeshëm mbizotëron numri i lëndëve nga **materia administrative – 48 ose 41,37%**, kurse numri i lëndëve nga **materia penale dhe civile** të cilat janë kryer me **aprovimin** e kërkesës dhe me konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm është identik dhe numëron **34 lëndë ose 29,31%**.

Në **104 ose 38,51%** lëndë, të kryera në këshillat e shkallës së parë, ku **kërkesa për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm është refuzuar si e pa bazë** mbizotëron numri i lëndëve nga **materia civile 46 ose 44,23%**, pastaj pasojnë lëndët nga **materia administrative 37 ose 35,57%** dhe **21 lëndë ose 20,19%** nga **materia penale**.

Në 50 lëndë ose 18,51%, të kryera në këshillat e shkallës së parë, ku **kërkesa për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm është hedhur poshtë**, mbizotërojnë lëndët nga **materia civile 22 ose 44%**, pastaj vijojnë lëndët nga **materia administrative 17 lëndë ose 34%** dhe **11 lëndë nga materia penale ose 22%**.

Analiza e numrit të lëndëve të kryera, në këshillat e shkallës së parë dhe parametrat e kërkesave të aprovuara, të refuzuara dhe të hedhura poshtë në periudhën raportuese, tregojnë se mbizotëron numri i lëndëve **të kryera me aprovimin** e kërkesës për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm, posaçërisht në lëndët nga **materia administrative**. I konsiderueshëm është edhe numri i **118 lëndëve ose 30,4%** lëndë të cilat kanë mbetur të pa kryera, ku mbizotërojnë lëndët nga **materia administrative – 62 lëndë ose 52,5%**, kundrejt numrit **31 lëndë ose 26,5% nga materia penale dhe 25 lëndë ose 21% nga materia civile**.

Duke i marrë parasysh parametrat, që i çmon këshilli gjatë vendimmarrjes së kërkesës konkrete për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm, siç është komplikimi i lëndës, kohëzgjatja e procedurës, sjellja e palëve në procedurë dhe sjellja e gjykatës që ka vepruar, cenime më të shpeshta të procedurës për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm që ka përfunduar me aprovimin e kërkesës, mund të konstatojmë në **lëndët administrative**, si dhe një numër i madh i lëndëve kanë mbetur në punë, për shkak të mos dorëzimit ose jo kompletimit në kohë të shkresave të lëndës.

Zgjatja e procedurës në këshillat e shkallës së parë

Në këshillat e shkallës së parë **janë kryer 270 lëndë**, në të cilat kohëzgjatja e procedimit për kërkesat e deklaruara për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm, e përfshin

periudhën nga pranimi i kërkesës e deri në ekspedimin e aktvendimit të shkallës së parë parashtuesit të kërkesës.

Zgjatja e procedurës – afat të arsyeshëm për vitin 2020, shkalla e I

| | Gjithsej në punë | Të kryera | Deri në 1 muaj | Deri në 2 muaj | Deri në 3 muaj | Deri në 6 muaj | Mbi 6 muaj | Kanë mbetur për punë |
|-----------------|------------------|------------|----------------|----------------|----------------|----------------|------------|----------------------|
| PSRRU | 164 | 102 | 3 | 1 | 8 | 25 | 65 | 62 |
| PSRRG | 127 | 102 | 5 | 8 | 10 | 38 | 41 | 25 |
| PSRRK | 97 | 66 | | 2 | 7 | 19 | 38 | 31 |
| GJITHSEJ | 388 | 270 | 8 | 11 | 25 | 82 | 144 | 118 |

Nga gjithsej 270 lëndët e kryera të shkallës së parë ose 69,58%

- në periudhën deri në 1 muaj, janë kryer **8 lëndë** ose **2,96%**, nga të cilat:
 - PSRRU – 3 lëndë**
 - PSRRK – 5 lëndë**
- në periudhën deri në 2 muaj, janë kryer **11 lëndë** ose **4,07%**, nga të cilat:
 - PSRRU – 1 lëndë**
 - PSRRG – 8 lëndë**
 - PSRRK – 2 lëndë**
- në periudhën deri në 3 muaj, janë kryer gjithsej **25 lëndë** ose **9,26%**, nga të cilat:
 - PSRRU – 8 lëndë**
 - PSRRG – 10 lëndë**
 - PSRRK – 7 lëndë**
- në periudhën deri në 6 muaj, janë kryer gjithsej **82 lëndë** ose **30,37%**, nga të cilat:
 - PSRRU – 25 lëndë**
 - PSRRG – 38 lëndë**
 - PSRRK – 19 lëndë**
- në periudhën prej më shumë se 6 muaj, janë kryer **144 lëndë** ose **53,33%**, nga të cilat:
 - PSRRU – 65 lëndë**
 - PSRRG – 41 lëndë**
 - PSRRK – 38 lëndë**
- në vitin **2021** kanë mbetur për punë **118 lëndë** ose **30,41%**, nga të cilat:
 - PSRRU – 62 lëndë**
 - PSRRG – 25 lëndë**
 - PSRRK – 31 lëndë**

Shkak për tejkalimin e afatit prej **6 muajve** si kornizë ligjore, për kryerjen e këtij lloji të lëndëve në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, kurse dukshëm nga numri i **118 lëndëve** të pa kryera, kryesisht është mungesa e shkresave të lëndëve, për të cilat ka të bëjë kërkesa. Në fakt, pas evidentimit të kërkesës për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm dhe formimin e lëndës, obligim i gjyqtarit – referues është që t'i kërkojë me shkrim – me urgjencë shkresat e lëndës nga gjykata në të cilën është zhvilluar procedura. Duke marrë parasysh të theksuarën, rrjedh prononcimi i vonuar i gjyqtarëve, të cilët veprojnë me lëndët, përkatësisht numri i madh i lëndëve të pa kryera në këshillin e parë edhe krahas urgjencave të shumta të dërguara për dorëzimin e shkresave për kërkesën e parashtuar në gjykatën, e cila ka vepruar për lëndën konkrete, për të cilën ka të bëjë kërkesa për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm.

Në këtë kontest, mungon mjeti juridik, me të cilin Gjykata supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, do t'i imponojë gjykatat më të ulëta për dorëzimin më të shpejtë të shkresave të lëndës, veçanërisht në rastet kur lënda për të cilën ka të bëjë kërkesa për mbrojtjen e të drejtave për gjykim në afat të arsyeshëm është lëndë aktive, përkatësisht lëndë që është në rrjedhë, ku vlen rregulli për tu krijuar kushte që procedura e lëndës të vazhdojë në fazën, në të cilën gjendet dhe të mos e pres vendimmarrjen e kërkesës për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm. Pamundësia, që në të gjitha rastet të respektohet afati prej **6 muajsh** për vendimmarrjen e kërkesës për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm vërehet në çdo periudhë - vit raportues të deritanishëm. Ky konstatim, ka qenë lëndë diskutimi edhe në seancat e Sektorëve, ku janë nxjerrë konkluzione përkatëse, të cilat vet në vete nuk mund të japin rezultat, nëse sipas sistemit nuk janë në dispozicion edhe për shqyrtimin e rregullave të procesit për vendimmarrjen e këtij lloji të lëndës, si dhe objektivitetin e kornizës së vendosur ligjore, e cila nuk korrespondon me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njerëzve. Në fakt, me kornizën ligjore prej **6 (gjashtë) muajsh** dhe mos krijimin e kushteve të procesit për përshpejtimin e procedurës, përkatësisht, vendimmarrjen e lëndëve në atë afat edhe në të dyja shkallët e vendimmarrjes në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, vet më vete do të thotë dhënia e mundësisë palëve – kërkuarve për tu ankuar edhe për zgjatjen e procedurës në këtë Gjykatë.

Pamundësia e Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në të gjitha rastet për ta respektuar afatin – kornizën prej **6 (gjashtë) muajsh** për përfundimin e procedurave të kërkesës për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm, nënkuptojnë edhe obligim për shqyrtimin e afatit ligjor, në kontekst të konsistencës së procedurës në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njerëzve dhe praktikën e kësaj gjykate. Në këtë kontekst, përsëri potencohet obligimi i kryetarëve të gjykatave, për tu angazhuar për dorëzimin e shkresave të lëndëve, për të cilat bëhet vlerësimi i procedimit në afat të arsyeshëm, e tërë kjo me qëllim që Gjykata supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, që të mund të respektojë afatin për gjykim në afat të arsyeshëm, duke marrë parasysh se pasojat e veprimtimit jo në kohë të duhur sipas detyrimit për dorëzimin e shkresave të lëndëve, të cilat nevojiten për veprimin e kërkesave për gjykim në afat të arsyeshëm, reflektohet në procedimin e tërësishëm për këto lëndë në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, e me këtë edhe të vlerësimin të efikasitetit për mjetin juridik. Me kuptim të ndjekjes së efikasitetit të mjetit juridik është të insistohet përmes kryetarëve të gjykatave, që me kohë të jepen të dhëna për respektimin e afateve që janë dhënë nga kjo gjykatë për kryerjen e lëndëve që janë në rrjedhë, në fazë të procesit të vendimmarrjes, për të cilën ka të bëjë kërkesa për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm.

Pasqyra totale e punës së lëndëve në këshillin e shkallës së dytë

Gjatë vitit **2020**, këshilli i ankesave të shkallës së dytë gjithsej në punë ka pasur **160** lëndë ose **29,20%** nga gjithsej numri i lëndëve në këtë Sektor, nga të cilat të reja të pranuar janë **129** lëndë ose **80,6%**, kurse **31** lëndë ose **19,4%** kanë mbetur të pa kryera nga periudha e kaluar raportuese. Këshilli i shkallës së dytë, në periudhën raportuese ka kryer **122** lëndë ose **76,25%** përderisa **38** lëndë ose **23,75%** kanë mbetur të pa kryera.

Mënyra e vendimmarrjes – afat të arsyeshëm për vitin 2020, shkalla e II

| | Të pa kryera nga periudha e kaluar | Të reja të pranuar | Gjithsej në punë | Të kryera | Të hedhura poshtë | Të refuzuara | Të aprovuara | Në tjetër mënyrë | Të pa kryera në fund të periudhës |
|-----------------|------------------------------------|--------------------|------------------|-----------|-------------------|--------------|--------------|------------------|-----------------------------------|
| PSRRZH | 31 | 129 | 160 | 122 | 3 | 91 | 28 | | 38 |
| GJITHSEJ | 31 | 129 | 160 | 122 | 3 | 91 | 28 | | 38 |

Këshilli i shkallës së dytë, gjatë vitit **2020 ka kryer 122 lëndë ose 31,12%** nga gjithsej **392 lëndët** e kryera në këtë Sektor, nga të cilat:

Në **91 lëndë ose 74,59%** ankesa është **e refuzuar** si e pabazë,
 Në **28 lëndë ose 22,95%** ankesa është **e aprovuar** dhe
 Në **3 lëndë ose 2,5%** ankesa është **hedhur poshtë**,

Analiza e gjithsej numrit të lëndëve të kryera, në këshillin e shkallës së dytë sipas strukturës tregon tendencë të periudhës relativisht të shkurtër, të veprimit me lëndët respektivisht mbizotëron numri i lëndëve të kryera, ndërsa parametrat e kërkesave të aprovuara, të refuzuara dhe të hedhura poshtë, në periudhën raportuese tregojnë se mbizotëron numri i lëndëve – të kryera me refuzimin e ankesës si të pabaza respektivisht me **konfirmimin e aktvendimit të shkallës së parë** në gjithsej **91 lëndë**.

Zgjatja e procedurës në këshillin e shkallës së dytë

Zgjatja e procedurës, në këshillin e shkallës së dytë në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, kompetente për vendimmarrjen e ankesave të deklaruara kundër aktvendimeve të shkallës së parë, përfshin periudhën nga pranimi i ankesës në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, deri në ekspedimin e aktvendimit të shkallës së dytë parashtuesit të kërkesës. .

Zgjatja e procedurës – Afat të arsyeshëm për vitin 2020, shkalla e II

PSRRZH

| Gjithsej në punë | Të kryera | Deri në 1 muaj | Deri në 2 muaj | Deri në 3 muaj | Deri në 6 muaj | Mbi 6 muaj | Kanë mbetur për punë |
|------------------|-----------|----------------|----------------|----------------|----------------|------------|----------------------|
| 160 | 122 | 19 | 35 | 21 | 35 | 12 | 38 |
| 160 | 122 | 19 | 35 | 21 | 35 | 12 | 38 |

Nga gjithsej numri i **160 lëndëve** në punë në këshillin e ankesave të shkallës së dytë, janë kryer gjithsej **122 lëndë**, nga të cilat:

- për periudhën deri në **1 muaj** procedura ka përfunduar në **19 lëndë ose 15,57%**,
- për periudhën deri në **2 muaj** procedura ka përfunduar në **35 lëndë ose 28,68%**,
- për periudhën deri në **3 muaj** procedura ka përfunduar në **21 lëndë ose 17,21%**,
- për periudhën deri në **6 muaj** procedura ka përfunduar në **35 lëndë ose 28,68%**,
- për periudhën me mbi **6 muaj** procedura ka përfunduar në **12 lëndë ose 9,83%**,
- kanë mbetur për punë në vitin **2021 - 38 lëndë ose 23,75%**.

Analiza e kohës për kryerjen e lëndëve në këshillin e ankesave, tregon **respektimin relativ të afatit prej 6 muajsh**, si kornizë ligjore për vendimmarrjen e lëndëve edhe në të dyja shkallët e vendimmarrjes në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Kjo, veçanërisht sepse gjatë procedimit të kornizës ligjore prej 6 muajsh nuk është marrë parasysh koha e nevojshme për dorëzimin e lëndëve të kryera në shkallën e parë drejtuar palëve dhe rrjedhja e afatit për ankesë. Nga këtu, koha e vendimmarrjes së lëndëve në këshillin e ankesave të marrë vetëm për vete determinon se, afati për procedimin sipas këtij lloji të lëndëve në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut është jo konsekuente me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njerëzve.

Kompensimi i drejtë

Nga gjithsej **392 lëndët** e kryera të këtij Sektori, nga të cilët **270 lëndë** në shkallën e parë dhe **122 lëndë** në shkallën e dytë, për të cilat është marrë vendim në Sektorin për gjykim në afat të

arsyeshëm, në vitin **2020**, shuma **maksimale** e shqiptuar në emër të kompensimit të drejtë, për shkak të cenimit të së drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm, në këshillat e shkallës së parë në **116** kërkesa të **aprovuara** numëron **4.770.000** denarë dhe ka të bëjë për më shumë parashtrues, të cilët të drejtën e tyre për gjykim në afat të arsyeshëm e kanë realizuar me një kërkesë, përdërisa shuma e shqiptuar **minimale** në **këshillat e shkallës së parë** është **1.000** denarë. Shuma maksimale e shqiptuar në emër të kompensimit të drejtë është për shkak të cenimit të së drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm **në këshillin e ankesave të shkallës së dytë**, në **28** ankesa të **aprovuara**, numëron **90.000** denarë, ndërsa shuma **minimale** në emër të kompensimit të drejtë nga ana e shkallës së dytë numëron **5.000** denarë.

Nga **392** lëndët e kryera në këtë Sektor, në vitin **2020** në **shkallën e parë** është shqiptuar kompensim i drejtë në vlerë prej **8.058.900** denarë kurse në **këshillin e shkallës së dytë** kompensimi i shqiptuar është **391.800** denarë ose shuma totale në të dyja shkallët e vendimmarrjes prej **8.450.700** denarë, si dhe në emër të kompensimit të drejtë, ashtu edhe për shpenzimet e procedurës për kërkesat e parashtruara për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm.

SEANCA E SEKTORIT

Në seancat e Sektorit për gjykim në afat të arsyeshëm, janë shqyrtuar çështje të rëndësishme juridike, të cilat burojnë nga lëndët e formuara të kërkesave për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm, dhe njëkohësisht janë shqyrtuar edhe raportet mujore të punës së këshillave të këtij Sektori. **Gjatë vitit 2020, Sektori për gjykim në afat të arsyeshëm mbajti 2 – dy seanca edhe atë më 02.03.2020 dhe më 13.07.2020**, në të cilat janë nxjerrë 4 (katër) konkluzione.

SEKTORI I PRAKTIKËS GJYQËSORE

Sipas Vendimit të Raportit vjetor, për punën e gjyqtarëve dhe të administratës gjyqësore për vitin 2020, të datës 31.12.2019 dhe Vendimet për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Orarit vjetor për gjyqtarët dhe administratën gjyqësore, për vitin 2020 të datës 16.01.2020, 18.03.2020 dhe 15.09.2020 në Sektorin e praktikës gjyqësore kanë marrë pjesë kryetarët e katër sektorëve, kryetarët e këshillave, bashkëpunëtorët profesional gjyqësorë, sekretarët dhe zëvendësit e sekretarëve të sektorëve dhe këshilltari gjyqësor i angazhuar për azhurnimin e faqes zyrtare të Gjykatës dhe publikimin e praktikës gjyqësore në faqen zyrtare të gjykatës.

Për realizimin e qëllimit themelor, Sektori i praktikës gjyqësore në vitin 2020, i ndoqi kuptimet dhe qëndrimet e përgjithshme juridike të rëndësishme për sigurimin e unitetit në zbatimin e ligjit përmes studimit të praktikës së gjykatave vendore dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njerëzve dhe praktikat – krahasimet e gjykatave nga sistemi i kaluar juridik i vendeve përreth. Njëkohësisht, ka marrë pjesë në përpilimin e projektit të kuptimeve juridike dhe materialeve tjera të seancave të sektorëve gjyqësorë dhe të Seancës së përgjithshme; i evidentoi qëndrimet parimore dhe mendimet juridike parimore të Seancës së përgjithshme, mendimet juridike dhe konkluzionet e pranuar në seancat e sektorëve, në seancat e gjyqtarëve dhe sentencat e këshillave; realizoi seleksionimin dhe evidentimin e vendimeve me vlerë juridike (vendime të rëndësishme) në rastet për të cilat pritet të jenë me vlerë të veçantë për praktikën gjyqësore; i kontrolloi vendimet e këshillave për shkak të verifikimit nëse vendimi është në përputhje me kuptimin juridik, të shprehur në ndonjë vendim të mëparshëm ose të së njëjtës kohë; e ndoqi, studioi dhe morri pjesë në harmonizimin e praktikës gjyqësore – unifikimin në zbatimin e ligjeve në nivel të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe gjykatat në Republikën e Maqedonisë së Veriut, përmes ndjekjes konsekuente të normave juridike dhe përmirësimit të tyre dhe kontribuoi në unifikimin e veprimit të drejtë të gjykatave lidhur me zbatimin dhe citimin e

praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njerëzve, në vendimet e gjykatave në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Sektori i praktikës gjyqësore, ka vepruar edhe me lëndë të formuara sipas kërkesave të parashtruara nga subjekte të ndryshëm (avokatë, persona juridik, qytetarë) për miratimin e qëndrimeve juridike dhe mendimeve juridike parimore për çështje me kuptim të sigurimit të unitetit në zbatimin e ligjeve nga ana e gjykatave dhe për kërkesa të parashtruara që kanë të bëjnë me dallimet në zbatimin e ligjeve nga ana e gjykatave në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe unifikimin e praktikës gjyqësore.

Vëllimi dhe kualiteti i punës

Lidhur me sigurimin e unifikimit horizontal dhe vertikal të praktikës gjyqësore, respektivisht realizimit të qëllimit themelor – sigurimin e unitetit në zbatimin e ligjeve nga ana e gjykatave, Sektori i praktikës gjyqësore gjatë vitit 2020, i ka ndjekur kuptimet dhe qëndrimet e përgjithshme juridike me rëndësi për sigurimin në zbatimin unik të ligjit përmes studimit të praktikës së gjykatave vendore dhe institucioneve ndërkombëtare.

Sektori i praktikës gjyqësore, në kuadër të punës së tij të rregullt, gjatë vitit 2020, mori pjesë në përpilimin e projektit të qëndrimeve juridike dhe të mendimeve juridike parimore në Seancën e përgjithshme të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, mendimeve dhe konkluzioneve juridike të sektorëve të specializuar dhe sentenca të pranuar të këshillave, si dhe në evidentimin e tyre me sistematizimin e sferave juridike dhe publikimin në faqen zyrtare të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në pjesën e praktikës gjyqësore.

Gjatë vitit 2020, Sektori i praktikës gjyqësore bëri seleksionimin, evidentimin dhe sistematizimin e sferave juridike të vendimeve me vlerë juridike (vendime të rëndësishme) të këshillave gjyqësor të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në dosjen “Praktika gjyqësore”, që përfaqëson bazë të brendshme së të dhënave në dispozicion për të gjithë gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët profesional gjyqësor, të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Po ashtu, nga ana e Sektorit të praktikës gjyqësore janë ndjekur vendime të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, dhe me qëllim të unifikimit të praktikës gjyqësore është bërë kërkimi i vendimeve identike apo të ngjashme në bazën e të dhënave, të cilën e ka Sektori i praktikës gjyqësore, në AKMIS programin përmes sporteleve dhe të faqes zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në të cilën publikohen vendime të anonimizuar të Gjykatës.

Në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut në vitin 2020, janë miratuar dhe publikuar në faqen zyrtare 1 (një) mendim juridik parimor, 4 (katër) mendime dhe konkluzione juridike dhe 6 (gjashtë) sentenca:

| | | |
|----------------------------------|---|---|
| Mendime juridike parimore | 1 | - Kufizimi i të drejtave nga marrëveshja kolektive nëse në kohën e vlefshmërisë së marrëveshjes kolektive miratohet ligj |
| Qëndrime parimore | / | |
| Mendime dhe konkluzione juridike | 4 | - Vonesa e kreditorit - Kthimi i shumës në emër të kompensimit të dëmit për shkak të lëndimit trupor, përkeqësimit të shëndetit dhe vdekjes - Konstatimi i mosekzistimit të borxhit për shkak të parashkrimit të kërkesës |

| | | |
|----------|---|---|
| | | - Organ kompetent për pagesën e detyrueshme të paushallit gjyqësor si shpenzim i procedurës |
| Sentenca | 6 | <ul style="list-style-type: none"> - Ofertë e marrëveshjes së re të ndryshuar - puna të njëjti punëdhënës si kusht për transformimin e marrëdhënies së punës nga koha e caktuar në kohë të pacaktuar - Përgjegjësia solidare e pronarit të automjetit për dëmin që e ka shkaktuar drejtuesi i automjetit - Hedhja poshtë e veprimeve juridike të debitorëve që kur kreditori nuk ka pasur sukses në përmbushjen e kërkesës për pronën ndaj të cilës është justifikuar e drejtë e pengut - Zyrtarizmi real dhe kompensimi - Lejueshmëria e revizionit dhe qasja në Gjykatë |

Spektori i praktikës gjyqësore, gjatë vitit 2020 ka vepruar në 45 lëndë, të evidentuara nën SPR numër, të cilat janë formuar sipas kërkesave të parashtruara për miratimin e qëndrimeve parimore dhe mendimeve juridike parimore, për çështje me kuptim të sigurimit të unitetit me zbatimin e ligjeve nga ana e gjykatave në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe unifikimin e praktikës gjyqësore, me shkresat e dorëzuara nga gjykatat dhe me shkresat nga Ministria e drejtësisë, Byrosë për përfaqësimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njerëzve, lidhur me praktikën gjyqësore dhe lëndët të cilat kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut zhvillohen në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njerëzve në Strasburg.

SEANCA TË SEKTORIT

Në kuadër të punës së tij të rregullt, Spektori i praktikës gjyqësore mbajti 3 seanca gjatë vitit 2020, të evidentuara nën SPZ numër. Këto seanca, përgatiteshin në mënyrë që me evidentimin e lëndës me SPR numër, për të cilën është konstatuar se nevojitet të shqyrtohet në seancë të Sektorit të praktikës gjyqësore, e njëjta skanohet dhe vendoset në një dosje për anëtarët e Sektorit të praktikës gjyqësore, përkatësisht në dosjen LIGJE (e cila gjendet në Desktop ose në sipërfaqen punuese të çdo kompjuteri statik), në nëndosjen SEANCA – Praktika gjyqësore, dosja “material i ri për seancë të Sektorit”. Mbajtja e seancave të Sektorit të praktikës gjyqësore, është zhvilluar përmes kompjuterëve personal, me prezencë fizike të anëtarëve të Sektorit të praktikës gjyqësore ose përmes platformës elektronike ZOOM, pa prezencë fizike të anëtarëve të Sektorit të praktikës gjyqësore, me asistencë të Qendrës IT të Gjykatës.

Në Seancën e Sektorit të mbajtur më 10.07.2020, u konstatua mënyra e veprimit të Sektorit të praktikës gjyqësore me konkluzionet e nxjerra në seanca, në drejtim të asaj se me përgatitjen e Propozim procesverbalit që shqyrtohet nga anëtarët e Sektorit, veprimit menjëherë me nxjerrjen e konkluzioneve, me qëllim të efikasitetit më të madh në veprimin e Sektorit.

Lidhur me iniciativat e parashtruara në përputhje me nenin 37 të Ligjit të gjykatave, me të cilat kërkohet nga Seanca e përgjithshme e Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut të miratohet qëndrim parimor dhe mendim juridik parimor, Spektori i praktikës gjyqësore konstatoi se mënyra e vendosur e punës rezulton me zvarritjen e procedurës së iniciativave të parashtruara. Kjo, duke qenë se koha që është e nevojshme për përgatitjen e materialeve për seancë të Sektorit të praktikës gjyqësore, përgatitja dhe miratimi i procesverbaleve dhe të konkluzioneve të nxjerra të seancave, të cilat pastaj dorëzohen në Seancën e përgjithshme për procedim dhe vendimmarrje të mëtejme. Për shkak të së theksuarës, në seancën e mbajtur të datës

16.11.2020, Sektori i praktikës gjyqësore konstatoi se duhet të ndryshohet konkluzioni i nxjerrë në seancën e Sektorit të praktikës gjyqësore të datës 05.07.2019, me vendosjen e tjetrit në vijim:

Aktivite tjera

Në mars të vitit 2020, është nënshkruar Memorandum për formimin e Trupit koordinues për ndjekjen e përhershme dhe përmirësimin e legjislativës nga ana e UD Kryetarit të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, kryetarëve të gjykatave të apelit dhe të Gjykatës së Lartë administrative.

PUNA E SEANCËS SË PËRGJITHSHME, TË GJYKATËS SUPREME TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Sipas Ligjit të gjykatave, në plotësim të kompetencave kushtetuese dhe ligjore, kryetari dhe të gjithë gjyqtarët e Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, morën pjesë në punën e Seancës së përgjithshme.

Gjykata supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, gjatë vitit **2020** ka mbajtur **19 Seanca të përgjithshme** në të cilat:

- është dhënë mendim për numrin orientues të lëndëve, që çdo gjyqtar duhet t'i kryejë për një muaj, në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

- Është aprovuar Raporti i punës së Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, për vitin 2019.

- janë miratuar aktvendime për 6 (gjashtë) ankesa të gjyqtarëve, të deklaruara kundër vendimeve për Raportin vjetor të punës, të miratuara nga kryetarë të gjykatave.

- janë miratuar aktvendime për 3 (tre) ankesa të gjyqtarëve, të deklaruara kundër aktvendimeve të Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, për udhëzimin e përkohshëm të ushtrimit të funksionit të gjyqtarit.

- janë shqyrtuar 14 (katërbëdhjetë) iniciativa për miratimin e qëndrimit parimor dhe mendimit juridik parimor, për të cilët është miratuar 1 (një) mendim juridik parimor që është publikuar në faqen zyrtare të gjykatës dhe janë nxjerrë 13 (trembëdhjetë) konkluzione se nuk pranohen iniciativat.

- është shqyrtuar për 1 (një) çështje juridike, për të cilën nuk u miratua mendim juridik parimor.

- në Seancë të zgjeruar të përgjithshme, janë shqyrtuar Raportet e punës së gjykatave në Republikën e Maqedonisë së Veriut, për vitin 2019.

- janë miratuar aktvendime për 7 (shtatë) kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë nga të cilat 1 (një) është parashtruar nga Prokuror publik i Republikës së Maqedonisë së Veriut, dhe 6 (gjashtë) nga persona fizik ose juridik.

- janë miratuar Vlerësimet dhe konkluzionet e raporteve të punës së gjykatave në Republikën e Maqedonisë së Veriut, për vitin 2019.

- janë emëruar 5 (pesë) këshilla për vendimmarrje të ankesave kundër aktvendimeve të Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut për shkarkimin e gjyqtarëve.

- vendimmarrja e kërkesave për përjashtim të UD së kryetarit dhe të gjyqtarëve të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, nga pjesëmarrja në këshillat për vendimmarrjen e ankesave kundër aktvendimeve të Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, për shkarkimin e gjyqtarëve dhe vendimmarrjen e kërkesave për përjashtimin e anëtarëve të emëruar të këshillave për vendimmarrjen e ankesave kundër aktvendimeve të Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut për shkarkimin e gjyqtarëve.

- është dhënë mendim me kërkesë të një kryetari të gjykatës, për sistemimin e gjyqtarit nga një sektor në tjetër.

- është emëruar zëvendës anëtarë i Këshillit drejtues të Akademisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve publik, nga radha e gjyqtarëve të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

- është miratuar vendim me kërkesë për fotokopjim të procesverbaleve nga seancat e përgjithshme, të mbajtura të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

- është siguruar mendim, për Orarin vjetor të punës së gjyqtarëve, të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, për vitin 2021.

- janë shqyrtuar Metodologjia për vlerësimin e Kryetarëve të gjykatave dhe Metodologjia për vlerësimin e punës së gjyqtarëve, të dorëzuara nga Këshilli gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

SEANCA TË GJYQTARËVE

Gjykata supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, gjatë vitit **2020** ka mbajtur **1 (një) Seancë të gjyqtarëve** në të cilën i vuri për shqyrtim:

- Metodologjinë e konstatimit të lëndëve të komplikuar, të dorëzuar nga Qendra për hulumtime dhe analiza juridike lidhur me projektin “Mbështetja e Këshillit gjyqësor në vendosjen e sistemit kualitativ për vlerësimin e gjyqtarëve”, të financuar nga Ambasada e Mbretërisë së Holandës.

- Metodologjia për vlerësimin kualitativ të gjyqtarëve dhe propozim për Metodologjinë e lëndëve të komplikuar, të dorëzuara nga Dr. Rajner Devil lidhur me projektin “Mbështetja e reformave në sektorin e jurisprudencës”, të financuar nga Bashkimi Evropian.

VIZITA DHE BASHKËPUNIME NDËRKOMBËTARE

Një delegacion i Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, i udhëhequr nga UD Kryetari i Gjykatës, me ftesë të Kryetarit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njerëzve, morri pjesë në solemnitetin tradicional me rastin e raportit vjetor, për punën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njerëzve në Strasburg.

Në periudhën prej 24 deri më 27 shkurt të vitit 2020, një delegacion i udhëhequr nga UD Kryetari i Gjykatës, morri pjesë në punën e konferencës së dytë me radhë në nivel të lartë të Rrjetit global për integritet të gjyqësisë me temë “E kaluara, e tashmja dhe e ardhmja”, që u mbajt në Doha Katar.

Gjyqtarë të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, më 23 prill 2020 përmes komunikimit elektronik morën pjesë në trajnimin e specializuar, në të cilin janë përfshirë 1220 gjyqtarë nga e tërë bota, me temë: “Leksione të mësuara nga bota për menaxhimin me gjykatat në kohë të pandemisë”, të organizuar nga Kolegji kombëtar gjyqësor nga SHBA, në bashkëpunim me Rrjetin Evropian për trajnim të gjyqësorit.

- Më 28 prill të vitit 2020, përmes komunikimit elektronik, gjyqtarë të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, morën pjesë në Tryezën e rrumbullakët rajonale me temë: “Pasojat nga pandemia KOVID - 19 mbi të drejtat e njeriut dhe sundimi i drejtësisë”, të organizuar nga Drejtoria për të drejtat e njerëzve dhe sundimi i drejtësisë pranë Këshillit të Evropës.

- Gjyqtarë të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, morën pjesë në Forumin e shtatë rajonal për sundimin e të drejtës në Evropën Juglindore, që u mbajt më 16 dhe 17 tetor të vitit 2020, në organizim të Qendrës AIRE dhe Organizatës Civil Rights Defenders, me temë KOVID – 19 dhe të drejtat e mbrojtura me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njerëzve.

Gjatë vitit, UD Kryetari i Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, realizoi takim me delegacione dhe përfaqësues të shumë institucioneve dhe organizatave ndërkombëtare:

- Më 21 janar, takim me Ambasadorin e SHBA, në Republikën e Maqedonisë së Veriut E.S. Kejt Mari Brns.
- Më 18 shtator, takim me Ambasadorin e Republikës së Austrisë, E.T. Dr. Georg Vucas.
- Më 22 shtator, takim me Ambasadorin e Republikës Sovjetike të Gjermanisë, E.T. Anke Hollshajtjn.
- Më 21.01.2020, takim Protokollar me Shefin e Delegacionit të Bashkimit Evropian, Ambasadorin David Gir.
- Më 09 korrik të vitit 2020, UD Kryetari i Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe kryetarët e sektorëve në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut realizuan takim me përfaqësues nga Qendra për hulumtime dhe analiza juridike dhe me ekspertë të projektit “Mbështetja e Këshillit gjyqësor në krijimin e sistemit kualitativ për vlerësimin e gjyqtarëve”, në koordinim me projektin “Mbështetja e reformave në sektorin e gjyqësisë”.

- UD Kryetari i Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në emër të gjykatave në Republikën e Maqedonisë së Veriut, nga Ambasadori i SHBA, pranoi donacion – mjete për dezinfektim për mbrojtjen e shëndetit të punësuarve dhe të qytetarëve.

QENDRA E INFORMATIKËS

Në Qendrën e informatikës, së Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut është vendosur pajisje harduerike – softuerike e tërësishme nga sfera e IKT dedikuar për funksionimin papengesë të GJSRMV dhe një pjesë për gjykatat e RMV dhe KGJRMV. Plotësuese në Qendrën e informatikës janë vendosur baza të caktuara të centralizuara për të dhënat, funksionalitetin centralizues, këmbimin e të dhënave të centralizuara me institucione nga jashtë etj., që dedikohen për punën pa pengesë për të gjitha gjykatat. Aktivitetet themelore për funksionimin pa pengesë për implementimin e sistemit IKT (planifikimin, pjesëmarrjen në projekte IKT zhvilluese, administrimin, menaxhimin, monitorimin, mbrojtjen, sigurinë, prokurime publike të centralizuara, përkrahja e shfrytëzuesve etj.) janë në perimetër të detyrave punuese të gjithsej 4 (katër) IKT inxhinierëve të punësuar në Qendrën e informatikës së GJSRMV.

Në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në funksion janë aplikacionet e shfrytëzuesve nga sfera e IKT me tendencë të rritjes së tyre në periudhën e ardhshme siç vijon:

- Aplikacioni për administrimin e procesionit të lëndëve gjyqësore (AKMIS).
- Aplikacioni për punën financiare dhe materiale (ABMS).
- Aplikacioni për publikimin e praktikës gjyqësore, të Gjykatës supreme të RMV dhe vendime të gjykatave të apelit në Ueb faqen për praktikën gjyqësore.
- Aplikacioni për publikimin e vendimeve gjyqësore, informacioneve, informacione të reja, të dhëna statistikore e të dhëna tjera të faqes zyrtare të Gjykatës supreme të RMV.
- Vendosja e centralizuar të Ueb Portalit gjyqësor dhe WEB portaleve së të gjitha gjykatave të RMV.
- Sistemi i postës elektronike dedikuar për të punësuarit në Gjykatën supreme të RMV dhe për njoftimin e shfrytëzuesve të sistemit për Dorëzimin elektronik të dokumenteve gjyqësore
- Aplikacioni për dorëzimin elektronik të dokumenteve gjyqësore (faza e parë – dorëzimi nga gjykatat te shfrytëzuesit), dedikuar për të gjitha gjykatat e RMV, me bazë të centralizuar për të dhënat e vendosura në Gjykatën supreme të RMV.
- Aplikacioni i evidencës ndëshkuese e dedikuar për të gjitha gjykatat e RMV, me bazë të centralizuar të vendosur në Gjykatën supreme të RMV.
- Backup (kopje) të centralizuar të AKMIS bazave nga të gjitha gjykatat e RMV.
- Servisi i centralizuar për këmbimin e të dhënave të drejtorëve të falimentimit me Regjistër Qendror të RMV, dedikuar për të gjitha gjykatat e RMV.
- Servisi i centralizuar për këmbimin e të dhënave ndërmjet gjykatave dhe prokurorive të Republikës së Maqedonisë së Veriut.
- Servisi i centralizuar për këmbimin e të dhënave ndërmjet gjykatave dhe Gazetës zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

IKT inxhinierët e punësuar në Qendrën e informatikës, së Gjykatës supreme të RMV, gjatë vitit 2020 kanë realizuar aktivitetet në vijim:

- Konstatimin e nevojave, përpunimin e specifikimit teknik të detajuar dhe kriteret për konstatimin e aftësisë, pjesëmarrjen në evoluim dhe realizimin (dhënia e përkrahjes teknike dhe ndjekja e përparimit në përputhje me planet e nënvizuara me afat) e procedurave për prokurim publik, të cilat i përfshijnë nevojat e të gjitha gjykatave të RMV dhe Këshillit gjyqësor të RMV nga sfera e IKT siç vijon:
 1. Mirëmbajtja harduerike – softuerike të pajisjes, të siguruar në kuadër të projektit IPA2010 kryesisht mirëmbajtjen preventive dhe adaptuese të ueb faqeve së të gjitha gjykatave të RMV dhe të Këshillit gjyqësor të RMV
 2. Mirëmbajtja adaptuese dhe preventive e sistemit AKMIS të implementuar në gjykatat e Republikës së Maqedonisë së Veriut kryesisht edhe mirëmbajtjen e aplikacioneve plotësuese dhe servisimin integruar në të njëjtin
 3. Mirëmbajtjen e Platformës IBM Lotus Domino, sistemin e – mail dhe aplikacionin ueb për publikimin e vendimeve nga praktika gjyqësore e Gjykatës supreme të RMV
 4. Mirëmbajtjen harduerike – softuerike dhe parapagesën vjetore të softuerit të Firewall Check Point arkitekturën e implementuar në të gjitha gjykatat e RMV dhe Këshillit gjyqësor të RMV.
 5. Mirëmbajtjen harduerike – softuerike dhe parapagesën vjetore softuerike të VMware infrastrukturën e implementuar në të gjitha gjykatat e RMV dhe Këshillit gjyqësor të RMV.
 6. Mirëmbajtjen e softuerit për grumbullimin, analizën dhe kërkimin e shënimeve log të pajisjeve të IKT të vendosura në GJSRMV
 7. Mbindërtimin e pajisjes për backup/restore të bazave për të dhënat e të gjitha gjykatave në RMV
 8. Mirëmbajtjen e post – garancisë së sistemit për klimatizimin preciz në sistem sallën e Gjykatës supreme të RMV.
 9. Mirëmbajtjen e sistemit UPS të vendosur në ndërtesën e Gjykatës supreme të RMV
 10. Furnizimi me materialet AOP për nevojat e Gjykatës supreme të RMV

11. Furnizimi me kompjuterë bartës për nevojat e gjyqtarëve të Gjykatës supreme të RMV.
 12. Furnizimi me licenca për pako për punë në zyrë
 13. Pjesëmarrje në Grupin punues të formuar nga Këshilli gjyqësor i RMV për përpunimin e specifikimit teknik dhe kritereve për konstatimin e aftësive në procedurën e furnizimit të Shërbimeve konsultuese për analiza dhe përgatitje të specifikimeve teknike për furnizimin e serverëve të rinj dhe pajisjeve tjera IKT në të gjitha gjykatat e RMV
 14. Pjesëmarrje në Grupin punues të formuar nga Këshilli gjyqësor të RMV për përpunimin e specifikimit teknik dhe kritereve për konstatimin e aftësive në procedurën për furnizimin e internet lidhjeve për të gjitha gjykatat e RMV dhe Këshillit gjyqësor të RMV
- Ndjekja e vazhdueshme e gjendjes dhe marrja e aktiviteteve adekuate me qëllim të funksionimit të papenguar të aplikacioneve të implementuara, të shfrytëzuesve, të dedikuara për GJSRMV dhe një pjesë për të gjitha gjykatat e RMV, në të gjitha fazat e zbatimit të tyre:
 - o Vërejtjen e pengesave të paraqitura, probleme të papritura, vërejtje dhe korrespondenca me përgatitësin e aplikacionit shfrytëzues për mënjanimin e tyre.
 - o Perceptimi i nevojave eventuale nga mbindërtimi dhe përmirësimi
 - o Ndarja adekuate e të drejtave të shfrytëzuesve dhe privilegjet
 - o Mbështetja e shfrytëzuesve të brendshëm dhe të jashtëm të cilët drejtohen në Qendrën e informatikës dhe kërkojnë ndihmë
 - o Përpunimi i raporteve të ndryshme statistikore për nevojat e shërbimeve gjyqësore dhe institucionet tjera
 - Planifikimi i mjeteve të nevojshme financiare për investimin dhe mirëmbajtjen në sferën IKT për të gjitha gjykatat e RMV dhe KGJRMV, planifikimin e nevojshëm për edukimin e vazhdueshëm të kuadrove IKT të punësuar në gjykatat e RMV dhe planifikimi i nevojshëm për punësime të reja të kuadrove profesionale IKT në Qendrën e informatikës së Gjykatës supreme të RMV.
 - Administrimi gradual, menaxhimi dhe ndjekja e sistemeve IKT të cilat janë të vendosura në Qendrën e informatikës së Gjykatës supreme të RMV, të dedikuara për Gjykatën supreme të RMV dhe një pjesë për të gjitha gjykatat e RMV.
 - Realizimi i përditshëm dhe kontrollimi i procedurave për mbrojtjen e të dhënave sistemuese dhe shfrytëzuesve (backup), të dedikuara për Gjykatën supreme të RMV dhe një pjesë për të gjitha gjykatat e RMV.
 - Monitorimin e logo sistemeve për paraqitjen e gabimeve të pajisjes së tërësishme të IKT, të vendosur në Qendrën e informatikës të Gjykatës supreme të RMV, me qëllim për mënjanimin eventuale të problemeve që hasen.
 - Ndjekja në vazhdimësi e performancave të sistemeve IKT, të vendosura me qëllim për marrjen e aktiviteteve përkatëse ose pasqyrimin e nevojave për përmirësimin e tyre.
 - Mirëmbajtja në vazhdimësi dhe administrimi i stacioneve punuese, notebook, kompjuterëve, printerëve, skanerëve.
 - Bashkëpunimin dhe koordinimin e Qendrës së informatikës të GJSRMV me sektorë të informatikës të gjykatave në RMV dhe KGJRMV, me qëllim të dhënies së rekomandimeve dhe udhëzimeve për marrjen e aktiviteteve të caktuara lidhur me funksionet e centralizuar, njoftimet për mirëmbajtjen e sigurt të sistemeve IKT të caktuara, procedura për lajmërimin e problemeve të shfaqura, dorëzimi i dokumentacionit të nevojshëm etj.
 - Ndjekja e vazhdueshme e teknologjive dhe trendëve të reja në sferën e IKT (pa edukim adekuat) duke shfrytëzuar literaturë që është në dispozicion në Internet.
 - Udhëheqja me dokumentacion të rregullt për realizimin e aktiviteteve sistemuese dhe shfrytëzuese, probleme të shfaqura, mënjanimin e tyre, udhëheqjen me raporte mujore për realizimin e detyrave punuese të IKT inxhinierëve nga Qendra e informatikës së GJSRMV dhe të ngjashme.

- Pjesëmarrja në punën e Këshillit të ri, të formuar për IKT në gjyqësinë, pjesëmarrja në takime pune për planifikimin dhe realizimin e projekteve IPA, pjesëmarrja në takime pune duke përfshirë edhe përpunimin dhe dorëzimin e të dhënave të nevojshme drejtuar ekspertëve të angazhuar në kuadër të projekteve IPA për mbështetjen e reformave në gjyqësinë, pjesëmarrja në Grupin punues për përshtatjen e Rregullores gjyqësore me rregullat e vlefshme ligjore etj.

Sipas të gjitha trendëve shoqërore bashkëkohore, imponohet nevoja për futjen e vazhdueshme të teknologjive të reja informatike dhe sistemeve IKT në sistemin gjyqësor të RMV, që të mundet përmes teknologjisë informatike bashkëkohore, edukative, kompatible dhe unifikuese të arrihet qëllimi përfundimtar, realizimi i lidhshmërisë efikase në të gjitha gjykatat e territorit të RMV dhe këmbimi i të dhënave me institucione tjera. Ajo, me automatizëm dhe dukshëm e zmadhon vëllimin e punës së vetëm 4 (katër) IKT inxhinierëve që janë në Qendrën e informatikës pranë GJSRMV.

Adekuatë për të, është evidente dhe e domosdoshme nevoja për punësimin e vazhdueshëm të IKT inxhinierëve profesional në Qendrën e informatikës, të cilëve do t'iu mundësohet edukim i vazhdueshëm dhe adekuat duke marrë parasysh se teknologjia e informatikës është sistemi më dinamik në çdo shoqëri bashkëkohore.

RESURSE NJERËZORE

Me Vendim të Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, është përcaktuar që funksionin e gjyqarit në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ta kryejnë **28 (njëzet e tetë) gjyqtarë**, ashtu që vendi i gjyqarit pezullohet për gjyqtarin, i cili është zgjedhur për anëtarë të Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në vitin 2019, me Vendim të Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut është larguar nga funksioni Kryetar i Gjykatës supreme dhe u emërua UD Kryetar, i cili ushtroi funksionin edhe gjatë vitit 2020.

Në vitin 2020, u shkarkuan nga funksioni Kryetari dhe dy gjyqtarë tjerë, të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Me vendim të Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në muajin e dytë të vitit 2020 janë zgjedhur tre gjyqtarë të ri.

Gjykata në vitin raportues, ka funksionuar me përbërje jo të plotë të gjyqtarëve me vetëm **22 (njëzet e dy) gjyqtarë**, që ishte bile edhe në kufij të minimaleve të nevojshme të funksionimit të Gjykatës, duke marrë parasysh kompetencat e saj, punën e Seancës së përgjithshme, punën në katër sektorë, Sektorin e veprave penale, Sektorin e veprave civile, Sektorin për gjykim në afat të arsyeshem dhe Sektorin e praktikës gjyqësore, që shkakton përjashtimin e gjyqtarëve dhe duhet riorganizim dhe ri sistemimi, me angazhimin e vazhdueshëm të bashkëpunëtorëve profesional gjyqësorë në më shumë këshilla.

Sipas Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës dhe plotësimin e të njëjtave mund të konstatohet se numri i nëpunësve gjyqësorë në Gjykatë aspak nuk i plotëson nevojat sipas vëllimit dhe ndërlikimin e kompetencës së Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në periudhën e kaluar, konstatohet derdhje dhe zbrazja e vendeve të punës nga të gjitha kategoritë e nëpunësve gjyqësorë për shkaqe të ndryshme, të cilat në kohë të duhur nuk plotësohen, ashtu që mungesa me të punësuar kompensohet me orarin e punës dhe nëpunësit gjyqësorë kryejnë më shumë punë dhe detyra zyrtare.

Në fund të vitit 2020, pas pëlqimit të siguruar nga Ministria e financave, janë realizuar 3 (tre) punësime sipas Ligjit për marrëdhëniet e punës, ndërsa vendi i punës për titullin Këshilltarë i pavarur gjyqësor 1 (një) realizues, i zbrazur me bazë të pensionimit nuk është plotësuar.

Pas pëlqimit të siguruar nga Ministria e financave për avancimin e nëpunësve gjyqësorë me publikimin e shpalljes interne (të brendshme), në dhjetor të vitit 2020 janë realizuar 22 (njëzet e dy) avancime të nëpunësve gjyqësorë nga të gjitha kategoritë sipas kushteve të plotësuara.

Gjykata supreme, vitin 2020 e përfundoi me **70** nëpunës gjyqësor të punësuar nga kategoria e nëpunësve udhëheqës, profesional dhe ndihmës nëpunës administrativ gjyqësor, **5** – policë gjyqësorë dhe **9** të punësuar në shërbimin teknik. Kështu numri i zvogëluar i nëpunësve gjyqësorë nuk përputhet me vëllimin e punës në gjykatë dhe me numrin e gjyqtarëve.

KONSTATIME PËRFUNDIMTARE

1. Gjykata supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në vitin 2020 kompetencat e saj kushtetuese dhe ligjore i ka realizuar në kushte të pandemisë së shkaktuar nga Kovid-19, me respektimin e Vendimeve të Kryetarit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Dekretet e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, të miratuara për mbrojtjen nga përhapja dhe bartja e virusit, të cilët kishin të bëjnë me lirim të obligueshëm nga obligimet e punës të një nga të dy prindërit për fëmijë deri më 10 vjet dhe fëmijë deri më 26 vjet me pengesa në zhvillim, lirim të grave shtatzëna dhe lirim të personave me sëmundje kronike, si dhe lirim nga obligimet e punës të personave detyrimisht të vetë izoluar ose karantinë, të cilët kryesisht e zvogëluan kapacitetin e punës së Gjykatës.

Por edhe krahas këtyre rrethanave objektive, të cilat janë shkaqe relevante dhe të arsyeshme nga ndikimi i realizimit të principit të azhurnimit dhe efikasitetit në veprimin e gjyqtarëve, bashkëpunëtorëve profesional gjyqësorë dhe të administratës gjyqësore rregullisht dhe në kohë i ka realizuar obligimet ligjore.

Shkalla e lartë e angazhimit të këtyre, së të gjithë faktorëve në Gjykatë kontribuuan që Gjykata supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në vitin raportues të tejkalojë grumbullimin e lëndëve të reja të pranuar dhe e zvogëloi numrin e lëndëve të pakryera për **322** lëndë nga të gjitha llojet.

Gjatë vitit, në Gjykatë në punë nga të gjitha llojet gjithsej kanë qenë **2512** lëndë, **1255** lëndë janë të pakryera nga viti i kaluar, ndërsa të reja të pranuar **2247** lëndë. Prej tyre, të kryera janë **2569** lëndë, ndërsa kanë mbetur të pakryera **943** lëndë.

Gjatë vitit, janë pranuar **2259** parashtresa të ndryshme nga **administrata gjyqësore** nga fushëveprimi i punës së Kryetarit të gjykatës dhe për të gjitha është proceduar.

2. Në Sektorin e veprave penale nga gjithsej numri i **1066** i lëndëve në punë, nga të gjitha llojet, gjatë vitit janë kryer **929** lëndë, respektivisht **87,14%**, ndërsa kanë mbetur të pakryera **137** lëndë.

Numri i madh i lëndëve, i nënshtrohet edhe pajisjes me kuadër të Sektorit me zgjedhjen e gjyqtarëve të rinj, nga të cilët dy u sistemuan në Sektorin e veprave penale.

Në gjithsej numrin e lëndëve të pakryera, gjithsesi ndikon edhe fakti se një pjesë e tyre janë pranuar në fund të vitit dhe ngase të njëjtët dorëzohen për mendim në Prokurorinë publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, prandaj nuk ka qenë e mundur të merren në punë.

3. Në Sektorin e veprave civile, grumbullimi i lëndëve është tejkaluar, ndërsa i lëndëve që kanë mbetur të pakryera është më i madh për **278** lëndë. Në fakt, Sektori ka vepruar për gjithsej **1873** lëndë, **918** janë të kryera nga viti i kaluar dhe **955** lëndë të reja të pranuar. Janë kryer **1233** lëndë, ndërsa të pakryera kanë mbetur **918** lëndë.

Vërehet zvogëlimi i grumbullimit të lëndëve, në vitin 2020 për **230** lëndë, por krahasuar me vitin 2019 kur janë kryer **1211** lëndë, në vitin 2020 janë kryer **22** lëndë më tepër.

4. Në Sektorin për gjykim në afat të arsyeshëm, në vitin raportues grumbullimi i lëndëve është tejkualuar në tërësi, ndërsa numri i lëndëve që kanë mbetur është zvogëluar për **31** lëndë.

Ky Sektor, ka vepruar gjithsej **548** lëndë për të gjitha bazat në të dyja shkallët e vendosjes, nga të cilat **177** janë lëndë të pakryera nga viti i kaluar, **361** lëndë të reja të pranuar dhe **10** lëndë të evidentuara përsëri. Janë kryer **392** lëndë, ndërsa kanë mbetur të pakryera **156** lëndë.

Kompensimi i shqiptuar në para, për shkak të konstatimit të cenimit të së drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm, në të dyja shkallët në vitin 2020 kap shumën prej **8.450.700,00** denarëve, që është rritur në krahasim me shumën e shqiptuar prej **3.806.800,00** denarëve, në vitin 2019. Lartësia e kompensimit të shqiptuar është në përputhje me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njerëzve, duke i marrë parasysh kompensimet e përcaktuara nga ajo gjykatë gjatë marrëveshjes miqësore të Republikës së Maqedonisë së Veriut me të aplikuarit.

5. Sektori i praktikës gjyqësore, në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, gjatë vitit **2020** i realizoi obligimet e shënuara sipas programit.

Iniciativat e parashtruara në Gjykatën supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në përputhje me nenin 37 të Ligjit të gjykatave, dorëzohen në Sektorin e praktikës gjyqësore, ku nga të dhënat në dispozicion për kërkim, është kryer verifikimi i praktikës gjyqësore të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, lidhur me çështjet juridike që rrjedhin nga iniciativat, për të cilat njoftohet Seanca e përgjithshme, nën kompetencën e të cilës është vendimmarrja për këto iniciativa.

Në drejtim të së theksuarës, Sektori i praktikës gjyqësore inicioi ndryshim të konkluzionit në Seancën e përgjithshme të Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, i miratuar më 17.10.2019, me qëllim të përsheptimit të procedurës dhe punës më efikase të Seancës së përgjithshme për iniciativat e parashtruara sipas nenit 37 të Ligjit të gjykatave.

Gjatë vitit 2020, përmes Sektorit të praktikës gjyqësore, Gjykata supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut e ndoqi praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njerëzve në Strasburg përmes analizës së vendimeve dhe seleksionimit të tyre me qëllim të implementimit më të lehtë të së njëjtëve në vendimet e Gjykatës supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Aktgjykimet e miratuara nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njerëzve kundër Republikës së Maqedonisë së Veriut, vazhdimisht janë azhurnuar në nëndosje adekuate në dosjen "Praktika gjyqësore e GJEDNJ", e krijuar në dosjen ekzistuese "Praktika gjyqësore", që në mënyrë interne (të brendshme) janë në dispozicion për të gjithë gjyqtarët dhe bashkëpunëtorët profesional gjyqësor.

6. Konstatim gjeneral që rrjedh nga të dhënat e punës dhe angazhimit të gjyqtarëve, dhe për shkak të rritjes së efikasitetit nevojitet që të plotësohen vendet e zbrazura të gjyqtarëve, ngase të gjithë gjyqtarët krahas punës me lëndë në sektor, kanë marrë pjesë në vendimmarrjen e kërkesave për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm në shkallën e parë dhe në këshillin e shkallës së dytë që vendos për ankesat kundër aktvendimeve të këshillit prej tre gjyqtarëve për kërkesat për gjykim në afat të arsyeshëm, në punën e Këshillit të specializuar që vendos për ankesë të kandidatit, i cili nuk është zgjedhur gjyqtarë, respektivisht Kryetarë i Gjykatës, në Këshillin e specializuar për vendosjen e ankesave kundër Vendimeve të Gjykatës administrative sipas nenit 62 të Ligjit për konteste administrative, me propozim për mbrojtjen për shkak të veprimit joligjor, në punën e Sektorit të praktikës gjyqësore së bashku me bashkëpunëtorët profesional gjyqësor.

7. Nëpunësit profesional gjyqësor, gjatë vitit raportues 2020, treguan shkallë të lartë operative me gjyqtarët në përpilimin e planit të vendimeve, si dhe shkallë të lartë profesionale, me përgjegjësi dhe azhurnim në kryerjen e obligimeve të veta, por edhe krahas kësaj për rritjen e efikasitetit në punën e Gjykatës, nevojitet plotësimi i vendeve të paplotësuara të punës nga radha e

udhëheqësve dhe këshilltarëve profesional gjyqësor sipas Rregullores për organizimin dhe sistematizimin e brendshëm të vendeve të punës në Gjykatë dhe Ligjit për shërbimin gjyqësor.

8. Duke marrë parasysh rolin dhe rëndësinë e nëpunësve gjyqësorë në Gjykatën supreme, si gjykatë më e lartë në Republikë, në procesin e sigurimit të veprimit efikas të gjykatës, të bëhen tentime për ndryshimin e Ligjit për shërbim gjyqësor dhe përmes saj të sigurohen mundësi për avancimin, shpërblimin dhe rritjen e numrit të nëpunësve gjyqësorë, posaçërisht në numrin e realizuesve në sportelet gjyqësore dhe numrin e realizuesve në Qendrën e informatikës.

9. Gjykata supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, sipas kompetencës së saj qëndrimet parimore dhe mendimet juridike parimore të miratuara, mendimet juridike dhe konkluzionet nga puna e Seancës së përgjithshme dhe mendimet juridike, konkluzionet dhe sentencat e miratuara në seancat e sektorëve, të vazhdojë në vazhdimësi ti publikojë në faqen zyrtare të Gjykatës, por edhe të vazhdojë praktikën e publikimit të Buletinit dhe të Përmbledhjes së vendimeve gjyqësore.

**GJYKATA SUPREME E
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT
SEANCA E PËRGJITHSHME**